



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LIGJI Nr. 03/L-201

PËR ENERGJINË ELEKTRIKE

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

LIGJ PËR ENERGJINË ELEKTRIKE

KREU I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi dhe fusha e veprimit

1. Me këtë ligj përcaktohen rregullat e përgjithshme për kryerjen e aktiviteteve të prodhimit, transmisionit, shpërndarjes dhe furnizimit të energjisë elektrike dhe qasjes në interkoneksion, organizimin e qasjes ndaj sistemit të transmisionit dhe sistemit të shpërndarjes, si dhe për funksionimin dhe qasjen ndaj tregut të energjisë elektrike në Kosovë.

2. Qëllimi i këtij ligji është:

- 2.1. që të zhvillojë një treg konkurrues dhe të qëndrueshëm të energjisë elektrike, me rregulla të përbashkëta sa i përket prodhimit,transmisionit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike dhe për qasje në treg;
- 2.2. të garantojë kushte për prodhim, transmetim, shpërndarje dhe furnizim të sigurt, të qëndrueshëm dhe të përhershëm me energji elektrike, duke iu përmbajtur parimeve të efijencës së energjisë;
- 2.3. të përcaktojë procedurat për dhënien e licencave për veprimtari në sferën e energjisë elektrike, dhe për autorizimet dhe tenderimin e kapaciteteve të reja;
- 2.4. të sigurojë që të gjithë konsumatorët shtëpiakë dhe, në rastet kur është teknikisht dhe ekonomikisht e arsyeshme, konsumatorët jo shtëpiakë të gëzojnë shërbim universal, do të thotë të drejtën e të furnizuarit me energji elektrike të një sasive dhe cilësie të specifikuar, në bazë të tarifave të arsyeshme, dhe
- 2.5. të sigurojë masa përkatëse për mbrojtjen e konsumatorëve fundorë, në veçanti masa adekuate për mbrojtjen e konsumatorëve në nevojë dhe konsumatorëve në zona rurale, përfshirë masat me të cilat u ndihmohet që t'i shmangen shkyçjeve.

Neni 2 **Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

- 1.1. **Shërbimet përcjellëse** - të gjitha shërbimet e nevojshme për operimin e sistemeve të transmisionit dhe shpërndarjes;
- 1.2. **Bilanci mes furnizimit dhe kërkesës** - përmbushja e kërkesës së parashikueshme të konsumatorëve për të shfrytëzuar energjinë elektrike pa pasur nevojë për zbatimin e masave për zvogëlimin e konsumit;
- 1.3. **Certifikata e origjinës** - një certifikatë e lëshuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji që përcakton përqindjen e energjisë elektrike për të cilën është lëshuar certifikata që është prodhuar nga burimet e ripërtëritshme të energjisë apo mbeturinat apo si bashkëprodhim i energjisë elektrike dhe ngrohjes në një njësi gjeneruese.
- 1.4. **Kongjestioni** - situatën në të cilën një interkoneksion që lidh sistemet kombëtare të transmisionit nuk mund të përballojë të gjitha rrjedhat fizike që rezultojnë nga tregtimet ndërkombëtare të kërkuara nga pjesëmarrësit në treg, për shkak të mungesës së kapacitetit të interkonektorit dhe/ose të njërit apo të dyja sistemeve kombëtare të transmisionit në fjalë;
- 1.5. **Rrjedha ndërkufitare** - rrjedha fizike e energjisë elektrike në interkonektor përtej kufirit të Kosovës dhe një shteti tjetër;

1.6. **Linjë direkte** - ose një linjë e energjisë elektrike që e lidh një lokacion të izoluar të prodhimit me një klient të izoluar; ose një linjë e energjisë elektrike që e lidh një prodhues të energjisë elektrike me një ndërmarrje për furnizim të drejtpërdrejtë për godinat, ndërmarrjet vartëse dhe konsumatorët e kualifikuar;

1.7. **Dispeçingu** - përcaktimin paraprak të orarit të funksionimit në sistemin e energjisë elektrike, për të siguruar se prodhimi i energjisë elektrike do të përmbush kërkesën e parashikueshme;

1.8. **Shpërndarja** - transportimi i energjisë elektrike përmes sistemeve të shpërndarjes, me qëllim të dërgimit së saj deri tek konsumatori, por duke mos përfshirë furnizimin;

1.9. **Sistemi i shpërndarjes** - kombinimi i linjave të energjisë elektrike dhe pajisjeve të energjisë elektrike me tension të lartë të mesëm dhe të ulët që shërbejnë për shpërndarjen e energjisë elektrike;

1.10. **Operatori i sistemit të shpërndarjes** - ndërmarrje energjetike përgjegjëse për operimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të shpërndarjes në një zonë të caktuar, si dhe ku është e mundur, interkonektorët e tij me sistemet tjera si dhe për sigurimin e aftësisë afatgjate të sistemit për të mbuluar kërkesat e arsyeshme për shpërndarjen e energjisë elektrike;

1.11. **Përparësia ekonomike** - klasifikimin e burimeve të furnizimit me energji elektrike të radhitura duke filluar nga çmimi më i lartë, në mënyrë që sa i përket prodhimit shtesë, burimet më të lira të dispeçohen së pari;

1.12. **Stabiliment i energjisë elektrike** - çdo instalim gjenerues të energjisë elektrike, central të energjisë elektrike (përfshirë pajisjet dhe sistemet ndihmëse dhe instalimet tjera të ndërlidhura), çdo instalim që përbën pjesë të sistemit të transmisionit apo të sistemit të shpërndarjes, çdo pajisje të konsumatorëve me lidhje të drejtpërdrejtë, çdo interkonektorë, apo çdo linjë direkte;

1.13. **Konsumator i kualifikuar** - konsumatori që është i lirë të blejë energji elektrike nga furnizuesi të cilin ai/ajo e zgjedh.

1.14. **Eksportimi i energjisë elektrike** - transmetimi i energjisë elektrike nga Kosova në një vend tjetër, në kuptimin se në të njëjtën kohë energjia elektrike do të pranohet nga ai vend;

1.15. **Konsumatori fundor** - konsumatori që blen energjinë elektrike për përdorimin vetanak;

1.16. **Prodhim** - prodhimi i energjisë elektrike.

1.17. **Kodi i Rrjetit** - kodin teknik lidhur me sistemin e transmisionit, që specifikohet në nenin 12 të këtij ligji;

- 1.18. **Konsumatorët shtëpiakë** - konsumatorët që blejnë energji elektrike për konsum vetanak për ekonominë familjare të tyre, duke mos përfshirë veprimtaritë komerciale apo profesionale;
- 1.19. **Interkonektorët** - pajisjet që përdoren për lidhjen e sistemeve elektrike;
- 1.20. **Sistem i interkonektuar** - një numër i sistemeve të transmisionit dhe shpërndarjes të lidhura së bashku përmes një ose më shumë interkonektorëve;
- 1.21. **Importimi i energjisë elektrike** - pranimi i energjisë elektrike në Kosovë nga një shtet tjetër me kuptimin se në të njëjtën kohë energjia elektrike do të pranohet.
- 1.22. **Operator i tregut** - ndërmarrjen energjetike të licencuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji për të operuar me tregun e energjisë elektrike në Kosovë;
- 1.23. **Pajisjet e matjes** - instrumentet e regjistruara në regjistrin për pajisjet matëse të certifikuara në Republikën e Kosovës, që përdoren për matje të energjisë së prodhuar, transmetuar, shpërndarë, furnizuar dhe të konsumuar;
- 1.24. **Konsumator i pakualifikuar** - të gjithë konsumatorët që nuk janë konsumatorë të kualifikuar;
- 1.25. **Konsumatorët jo shtëpiakë** - të gjithë personat fizikë dhe juridikë që blejnë energji elektrike e cila nuk është e destinuar për shfrytëzim në ekonominë e tyre familjare dhe këtu përfshihen prodhuesit dhe konsumatorët me shumicë;
- 1.26. **Siguria e operimit të sistemit** - operimi i vazhdueshëm i sistemit të transmisionit dhe, sipas nevojës, sistemit të shpërndarjes, sipas rrethanave të parashikueshme;
- 1.27. **Prodhues** - personi fizik ose juridik që prodhon energji elektrike;
- 1.28. **Furnizues publik** - ndërmarrja e energjisë elektrike e licencuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji për të kryer veprimtarinë e furnizimit publik;
- 1.29. **Furnizimi publik** - furnizimin e konsumatorëve fundor me energji elektrike me tarifa të rregulluar në pajtim me nenin 18 të këtij ligji.
- 1.30. **Reciprociteti** - që kushtet e qasjes në një sistem të transmisionit apo sistem të shpërndarjes dhe në treg në një shtet tjetër të jenë reciproke me ato në Kosovë dhe që konsumatorët e kualifikuar në atë shtet tjetër të konsiderohen si konsumatorë të kualifikuar në të dyja sistemet në fjalë;
- 1.31. **Siguria e furnizimit të energjisë elektrike** - mundësinë e sistemeve të energjisë elektrike për të furnizuar konsumatorët fundorë me energji elektrike, në pajtim me këtë ligj;

1.32. **Furnizues** - ndërmarrjen e energjisë elektrike të licencuar për të kryer veprimtari të furnizimit;

1.33. **Furnizim** - shitjen, përfshirë rishitjen, e energjisë elektrike tek konsumatorët;

1.34. **Shfrytëzuesit e sistemit** - personat fizikë dhe juridikë që e furnizojnë ose furnizohen nga një sistem i transmisionit ose shpërndarjes;

1.35. **Transit** - transportimi i energjisë elektrike përmes Sistemit të Transmisionit të Kosovës, me ç'rast as prodhimi dhe as pranimi korrespondues i energjisë elektrike nuk realizohet në Kosovë;

1.36. **Transmision** - transportimi i energjisë elektrike, përmes sistemeve të interkonektuara me tension të lartë, me qëllim të dërgimit deri te konsumatorët fundorë apo te operatorët e sistemit të shpërndarjes, por pa përfshirë furnizimin;

1.37. **Sistemi i transmisionit** - kombinimi i linjave të energjisë elektrike dhe njësisive të energjisë elektrike me tension të lartë që shërben për transmisionin e energjisë elektrike.

1.38. **Operator i Sistemit të Transmisionit** - person fizik ose juridik përgjegjës për operimin, sigurimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të transmisionit dhe, zhvillimin e rrjetit të transmisionit, aty ku aplikohet, interkonektorëve të vet me rrjete të tjera, dhe sigurimin e qëndrueshmërisë afatgjatë të rrjetit për të përballur me kërkesat për transmisionin e energjisë elektrike.

1.39. **Ndërmarrje vertikalisht e integruar e energjisë elektrike** - ndërmarrjen e energjisë elektrike apo grupin e ndërmarrjeve të energjisë elektrike, me ç'rast i njëjti person apo të njëjtit persona janë të autorizuar të ushtrojnë ndikim, drejtpërsëdrejti apo tërthorazi, dhe ku ndërmarrja apo grupi i ndërmarrjeve kryen së paku një nga funksionet e transmisionit dhe shpërndarjes dhe një nga funksionet e prodhimit dhe furnizimit me energji elektrike.

1.40 **Konsumator me shumicë** - të gjithë personat fizikë ose juridikë që blejnë energji elektrike me qëllim të rishitjes brenda sistemit në të cilin ata janë themeluar apo jashtë tij;

2. Termat tjerë në këtë ligj e që nuk janë të përkufizuara me këtë ligj do të kenë kuptimin e njëjtë me termat e përcaktuar në Ligjin për Energjinë dhe Ligjin për Rregullatorin e Energjisë.

KREU II

SISTEMI I ENERGJISË ELEKTRIKE

Neni 3

Sistemi i Energjisë Elektrike

1. Të gjitha stabilimentet elektrike të lidhura me Sistemin e Transmisionit apo Sistemin e Shpërndarjes në Kosovë do të operojnë si një sistem i vetëm i energjisë elektrike me një detyrë të përbashkët e të vazhdueshme për të prodhuar, transmetuar, shpërndarë dhe furnizuar me energji elektrike.

2. Sistemi i energjisë elektrike në Kosovë vepron në mënyrë paralele dhe mund të lidhet me sistemet e energjisë elektrike të vendeve të tjera në tregun rajonal të energjisë elektrike të Evropës Juglindore, dhe me sistemet e energjisë elektrike të shteteve tjera sistemet e të cilave janë në pajtim me standardet dhe kushtet e sigurisë të pranuar nga Bashkimi Evropian.

KREU III

PRODHIMI I ENERGJISË ELEKTRIKE

Neni 4

Prodhimi i energjisë elektrike

Prodhimi i energjisë elektrike kryhet nga ndërmarrjet e energjisë elektrike që posedojnë licencë për prodhim të lëshuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji ose persona fizikë apo juridikë që janë liruar nga detyrimi për t'u pajisur me licencë sipas Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.

Neni 5

Të drejtat e prodhuesve të energjisë elektrike

1. Prodhuesit e energjisë elektrike, me kusht që t'i përmbahen dispozitave të këtij ligji, Ligjit për Rregullatorin e Energjisë dhe licencat, kodet dhe rregullat tjera relevante të cilat miratohen nga Zyra e Rregullatorit për Energji, do të kenë të drejtat vijuese:

1.1. të shfrytëzojë burimet e energjisë që i konsideron më të përshtatshme për procesin e prodhimit në centralin e tij elektrik, me kusht që shfrytëzimi i burimeve në fjalë të jetë në përputhshmëri me të gjitha kushtet relevante teknike, mjedisore dhe të eficiencës së energjisë;

1.2. të lidhin centralet e tyre me sistemin e transmisionit apo sistemin e shpërndarjes;

1.3. të lidhin kontrata për shitjen e energjisë elektrike, kapaciteteve të energjisë elektrike dhe shërbimeve ndihmëse;

1.4. bëjnë transmisionin e energjinë elektrike të tyre përmes sistemit të transmisionit dhe/ose sistemit të shpërndarjes; dhe

1.5. faturojnë dhe inkasojnë kompensimin për të cilin autorizohen sipas kontratave dhe për të gjitha shitjet e energjisë, kapaciteteve apo shërbimeve shtesë.

Neni 6

Obligimet e prodhuesve të energjisë elektrike

1. Prodhuesi i energjisë elektrike ka për obligim:

1.1. t'i përmbahet të gjitha kushteve të përcaktuara në licencë për ushtrimin e veprimtarisë prodhuese, nëse një licencë e tillë kërkohet;

1.2. t'i përmbahet rregullave përkatëse teknike dhe rregullave të vendosura nga operatorët e sistemit, përfshirë edhe Kodin e Rrjetit dhe Kodin e Shpërndarjes;

1.3. të veprojë në pajtim me rregulloret mbi mbrojtjen e mjedisit për të siguruar kontroll të përhershëm mbi ndikimin në mjedis;

1.4. të pajiset me pajisje matëse adekuatë për matjen e energjisë elektrike që hyn në sistem; dhe

1.5. t'i përmbahet të gjitha obligimeve tjera që mund të rezultojnë nga zbatimi i këtij ligji dhe legjislacionit dhe rregulloreve, rregullave dhe kodeve të ndërlidhura

2. Prodhuesi i energjisë elektrike, në rastet kur së paku një nga asetet e tij të prodhimit ka kapacitet të instaluar prej më shumë se 5 MW, do t'i mbajë të dhënat për çdo orë funksionimin e impiantit të tij për një periudhë pesëvjeçare, në mënyrë që të verifikohen të gjitha vendimet operative të dispeçimit dhe trendët ofertuese në këmbim të energjisë, ankande të interkonektorëve, tregje të rezervave dhe tregjeve të letrave me vlerë, cilat ia vë në dispozicion Zyrës së Rregullatorit për Energji, Komisionit të Kosovës për Konkurrencën dhe të gjitha organizatave tjera ndërkombëtare që janë themeluar në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare apo rregulloreve ndërkombëtare që janë të obligueshme për Kosovën dhe që mbajnë mandat për të kryer funksione të tilla. Informatat për orë/për impiant që duhet ruajtur duhet të përfshijnë, pa u limituar vetëm në to, të dhënat mbi kapacitetet prodhuese në dispozicion dhe rezervat e dedikuara, përfshirë alokimin e këtyre rezervave të dedikuara në nivel të impiantit në kohën e kryerjes së ofertimit dhe gjatë realizimit të prodhimit.

Neni 7

Obligimet e Prodhuesve për të Ofruar Energji Elektrike

Të gjithë prodhuesit, që operojnë me centrale që kanë kapacitete të instaluar më të larta se 5MW, të cilët ekzistonin dhe ishin operativ në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do t'i ofrojnë furnizuesit publik energjinë elektrike të prodhuar në këto centrale, në bazë të tarifave të rregulluara në pajtim me nenin 41 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, në rast se furnizuesit publik i nevojitet e njëjta për t'i përmbushur obligimet e veta si furnizues publik.

Neni 8

E Drejta e Prodhuesit për Shitjen e Energjisë Elektrike

1. Në pajtim me nenin 7 të këtij ligji dhe me kushtet e përcaktuara në licencën e tij, prodhuesi mund të lidhë kontratë për shitjen e energjisë elektrike të prodhuar nga ai ose kapacitetin e centraleve të tij, kur është e nevojshme me përdorimin e shërbimeve të rregulluara të Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Operatorit të Sistemit të Shprëndarjes me çmime të negociuara lirshëm:

- 1.1. konsumatorëve të kualifikuar në Kosovë;
- 1.2. furnizuesve në Kosovë;
- 1.3. konsumatorëve të kualifikuar të jashtëm apo furnizuesve të jashtëm, për të cilin qëllim mund të eksportoje energji elektrike; dhe
- 1.4. furnizuesit publik, në rastet kur nuk zbatohet neni 7 i këtij ligji.

2. Bazuar në nenin 7 të këtij ligji dhe Kreut XII më poshtë, dhe kushteve të ndonjë licence përkatëse të cilën mban, prodhuesi gjithashtu mund të shesë energjinë elektrike të prodhuar nga ai, apo kapacitetin e impianteve të veta, në tregun e energjisë elektrike në Kosovë apo në tregun rajonal të energjisë elektrike.

Neni 9

Certifikatat e Origjinës

1. Ndërmarrjet e energjisë që prodhojnë energji elektrike duke shfrytëzuar burimet e ripërtërishme të energjisë apo përmes bashkëprodhimit kanë të drejtë të marrin certifikatën e origjinës nga Zyra e Rregullatorit për Energji.

2. Në certifikatën e origjinës, Zyra e Rregullatorit për Energji:

- 2.1. vërteton kapacitetin maksimal të centralit elektrik që shfrytëzon burimet si dhe burimet e shfrytëzuara për prodhim;

- 2.2. përcakton afatet për paraqitjen e informatave dhe raporteve të Zyra e Rregullatorit për Energji sa i përket operimit të centralit.
3. Furnizuesi publik i jep përparësi blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e ripërtëritshme të energjisë për të cilën është lëshuar certifikata e origjinës nga Zyra e Rregullatorit për Energji.
4. Nga furnizuesi publik kërkohet që ta blejë me tarifë të rregulluar, tërë sasinë e energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e ripërtëritshme të energjisë, të nevojshme për plotësimin e nevojave me energji elektrike në Kosovë, me përjashtim të sasisë për të cilën prodhuesi ka lidhur kontratë sipas dispozitave të këtij ligji.
5. Zyra e Rregullatorit për Energji do të realizojë aranzhime për të kompensuar shpenzimet shtesë me të cilat përballet furnizuesi publik për shkak të blerjes së energjisë elektrike sipas kushteve të përcaktuara në këtë nen, përmes një ngarkese specifike në shërbimet e Operatorit të Sistemit të Transmisionit, e cila u ngarkohet në mënyrë transparente dhe jo diskriminuese të gjithë furnizuesve dhe konsumatorëve fundor të lidhur në sistemin e transmisionit, në proporcion me konsumin e tyre.
6. Zyra e Rregullatorit për Energji harton një metodologji për përcaktimin e tarifave që duhen paguar nga furnizuesi publik për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e ripërtëritshme të energjisë sipas Ligjit për Rregullatorin e Energjisë. Kjo metodologji do të përfshijë dispozita për kompensimin e furnizuesit publik për koston shtesë për blerjen e energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e ripërtëritshme.

Neni 10

Rezervat e lëndëve djegëse

1. Prodhuesit e licencuar të energjisë elektrike me obligime për shërbim publik që ndërlidhet me rezervat e lëndëve djegëse, do të mbajnë sasi të mjaftueshme të rezervave të lëndëve djegëse për të siguruar prodhim të vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm të energjisë elektrike apo rezerva speciale për kapacitete prodhuese për të siguruar furnizim për konsumatorët.
2. Niveli i rezervave të lëndës djegëse dhe kapaciteteve prodhuese për rezervë speciale që duhet të mbajnë prodhuesit e energjisë elektrike me obligim të shërbimit publik përkitazi me rezervat e lëndëve djegëse, përcaktohet dhe publikohet nga Ministria rregullisht.

KREU IV TRANSMETIMI I ENERGJISË ELEKTRIKE

Neni 11 Operatori i Sistemit të Transmisionit

1. Operatori i Sistemit të Transmisionit mban në pronë dhe është përgjegjës për operimin e Sistemit të Transmisionit në Kosovë, dhe do të mbajë në pronë të gjitha asetet tjera që janë të domosdoshme për këtë veprimtari, në pajtim me licencën e lëshuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji.

2. Operatori i Sistemit të Transmisionit do të jetë shoqëri e pavarur aksionare, nuk do të jetë pjesë e ndonjë ndërmarrjeje vertikalisht të integruar të energjisë elektrike dhe do të jetë e pavarur nga veprimtaria që nuk ndërlidhet me transmisionin apo administrimin e tregut të energjisë elektrike, për sa i përket formës së saj juridike, organizimit dhe proceseve vendimmarrëse.

3. Në mënyrë që të sigurohet pavarësia e Operatorit të Sistemit të Transmisionit, personat përgjegjës për menaxhimin e tij nuk guxojnë, drejtpërsëdrejti apo tërthorazi, të marrin pjesë në struktura të kompanisë apo procese vendimmarrëse të Ministrisë, Zyrës së Rregullatorit për Energji, apo cilësdo ndërmarrje tjetër energjetike përgjegjëse për prodhim, mirëmbajtje, furnizim, shërbim, shpërndarje, apo për miniera të thëngjillit apo furnizim të lëndëve tjera djegëse.

4. Operatori i Sistemit të Transmisionit harton dhe Zyra e Rregullatorit për Energji do të miratojë një program të pajtueshmërisë i cili përcakton masat të cilat duhet të ndërmerren për eliminimin e sjelljeve diskriminuese dhe masat për të siguruar që zbatimi i këtij programi të monitorohet në mënyrë adekuate. Programi do të përcaktojë detyrimet specifike të punonjësve të Operatorit të Sistemit të Transmisionit për arritjen e këtij objektivi. Një raport vjetor publik i cili përshkruan masat të cilat janë ndërmarrë do të dorëzohet nga personi ose organi përgjegjës për monitorimin e programit të pajtueshmërisë në Zyrën e Rregullatorit për Energji.

Neni 12 Përgjegjësitë dhe të Drejtat e Operatorit të Sistemit të Transmisionit

1. Operatori i Sistemit të Transmisionit do të jetë përgjegjës për:

1.1. operimin, mirëmbajtjen dhe, zhvillimin e sistemit të transmisionit dhe interkonektorëve të tij me sisteme tjera, në mënyrë që të ofrojë siguri të operimit të sistemit dhe siguri në furnizim me energji elektrike;

1.2. menaxhimin e rrjedhave të energjisë në sistemin e transmisionit, rrjedhave ndërkufitare, dhe të gjitha kongestionet që mund të paraqiten, duke marrë parasysh këmbimet me sistemet e interkonektuara, në mënyrë që të mbahet

balanci mes furnizimit dhe kërkesës dhe të sigurohet eficiency ekonomike e menaxhimit të rrjedhave të energjisë;

1.3. përgatitjen e rregullave të balancimit dhe balancimin e sistemit të energjisë elektrike;

1.4. mbajtjen e një niveli adekuat të kapaciteteve të transmisionit si rezervë teknike, në mënyrë që të arrihet një nivel adekuat i sigurisë së operimit të rrjetit;

1.5. sigurimin e disponueshmërisë së të gjitha shërbimeve ndihmëse;

1.6. operimin e një mekanizmi për bashkërendim me operatorët e të gjitha sistemeve tjera me të cilët është i lidhur sistemi i transmisionit, dhe siguri i të gjitha informatave të domosdoshme për operatorët e sistemeve të tilla për të ofruar operim të sigurt dhe efikas, zhvillim të bashkërenduar dhe ndërveprim të sistemeve të interkonektuara, duke marrë në konsideratë nevojën për menaxhimin e kongestionit;

1.7. veprimin në pajtueshmëri me të gjitha standardet e cilësisë së furnizimit dhe sigurisë së sistemit që përcaktohen nga Zyra e Rregullatorit për Energji;

1.8. sigurimin që ndërprerjet në furnizim në situata emergjente për shkak të një ngjarje të përcaktuar në paragrafin 2. të nenit 22 të Ligjit për Energjinë, të bazohen në kritere të parapërcaktuara dhe objektive të cilat përpilohen nga Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe miratohen nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë;

1.9. garantimin e mosdiskriminimit mes shfrytëzuesve të sistemit apo kategorive të shfrytëzuesve të sistemeve;

1.10. kalkulimin dhe publikimin e parashikimeve ditore të kapaciteteve totale të transmisionit dhe kapaciteteve për transfer në dispozicion, dhe besueshmerin e pritur. Këto parashikime do të publikohen së paku një muaj më parë dhe do të azhurohen rregullisht;

1.11. identifikimin e kapaciteteve të transmisionit ndërkufitar në dispozicion dhe menaxhimin e kongestionit për të gjitha transaksionet në interkonektorët me sistemet fqinje në bazë të rregullave dhe mekanizmave të tregut të cilët përcaktohen dhe zbatohen së bashku me operatorët tjerë në tregun rajonal të energjisë elektrike. Operatori i Sistemit të Transmisionit do të hartojë rregulla për menaxhimin e kongestionit të cilat i dorëzon për miratim në Zyrën e Rregullatorit për Energji.

1.12. ofrimin e të gjitha informatave të nevojshme që mund t'ju duhen shfrytëzuesve të sistemit për t'iu qasur sistemit në mënyrë efektive;

1.13. dispeçimin e prodhimit;

1.14. dhënien e prioritetit për dispeçimin e prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme të energjisë dhe bashkëprodhimin, me kusht që të mos bie ndesh me limitet e përcaktuara për shkaqe të sigurisë së sistemit nga Kodi i Rrjetit dhe rregullat e rregulloret tjera;

1.15. hartimin dhe publikimin e rregullave standarde lidhur me atë se kush bartë shpenzimet për adaptimet teknike, siç janë kyçjet (lidhjet) në rrjet apo përforcimet e rrjetit, të cilat janë të domosdoshme për të integruar njësitë e reja prodhuese të energjisë në sistemin e interkonektuar. Këto rregulla duhet t'i dorëzohen për miratim Zyrës së Rregullatorit për Energji, dhe duhet të bazohen në kritere objektive, transparente dhe jodiskriminuese, dhe duhet marrë parasysh të gjitha shpenzimet dhe përfitimet që ndërlidhen me kyçjen e këtyre prodhuesve në sistem;

1.16. sigurimin e parashikimeve gjithëpërfshirëse të detajuara të shpenzimeve të ndërlidhura me lidhjen për të gjithë prodhuesit e ri të energjisë elektrike që duan të lidhen në sistemin e transmisionit, për të cilat parashikime Operatori i Sistemit të Transmisionit mund të kërkojë një pagesë që pasqyron shpenzimet e arsyeshme;

1.17. përcaktimin dhe publikimin e rregullave standarde lidhur me ndarjen e shpenzimeve për instalime të sistemit, siç janë kyçjet në rrjet dhe përforcimet e tij, mes të gjithë prodhuesve të energjisë elektrike që përfitojnë nga ai. Këto rregulla duhet t'i dorëzohen për miratim Zyrës së Rregullatorit për Energji dhe të jenë në pajtim me të gjitha aktet e zbatueshme nënligjore;

1.18. zhvillimin dhe propozimin e tarifave dhe metodologjive tarifore për shfrytëzimin dhe kyçjen në sistemin e transmisionit, të cilat janë jodiskriminuese dhe që ofrojnë sinjale efikase ekonomike për shfrytëzuesit e sistemit, përfshirë edhe sa i përket menaxhimit të kongestionit, çdo propozim i këtillë do të dorëzohet në Zyrën e Rregullatorit për Energji për miratim dhe publikim në pajtim me rregullat dhe procedurat e përcaktuara në Kreun IX të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;

1.19. organizimin e studimeve dhe aranzhimin e financimit për ndërtimin e linjave të reja të transmisionit, interkonektorëve dhe stabilimenteve tjera të domosdoshme për operim, mirëmbajtje, zhvillim dhe menaxhim të mirëfilltë të sistemit të transmisionit në Kosovë;

1.20. përmbushjen e detyrimeve që ndërlidhen me planin dhjetë (10) vjeçar për zhvillimin e sistemit sipas nën-paragrafit 5.6. të paragrafit 5. dhe paragrafit 6. të nenit 14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;

1.21. pajtueshmërinë me Kodin e Rrjetit dhe të gjitha kodet dhe rregullat tjera të zbatueshme;

1.22. marrjen parasysh të opinioneve dhe rekomandimeve dhe respektimin e vendimeve të institucioneve të krijuara në Komunitetin e Energjisë, apo në

Bashkimin Evropian, në rastet kur këto organizata janë të mandatuara nga marrëveshjet apo rregulloret ndërkombëtare të obligueshme për Kosovën;

1.23. bashkëpunimin me organizata nga nën-paragrafi 1.22 i këtij paragrafi në sigurimin e informatave të domosdoshme për monitorimin nga ato organizata lidhur me planet zhvillimore të rrjetit, përdorimit dhe zhvillimit të interkonektorëve dhe bashkëpunimit rajonal;

1.24. pjesëmarrjen në Rrjetin Evropian të Operatorëve të Sistemeve të Transmisionit të Energjisë Elektrike;

1.25. krijimin e ndërmarrjeve të përbashkëta, përfshirë atyre me operator tjerë të sistemit të transmisionit, këmbimet e energjisë elektrike, dhe akterët tjerë që kanë për qëllim objektivin e zhvillimit të tregjeve rajonale apo lehtësimin e procesit të liberalizimit, dhe

1.26. kryerjen e të gjitha veprimtarive tjera të parapara me këtë ligj dhe me ligjet tjera të zbatueshme.

2. Operatori i Sistemit të Transmisionit do t'i raportojë Zyrës së Rregullatorit për Energji, siç përcaktohet në licencën e tij dhe Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, dhe do t'i sigurojë të njëjtës informata mbi të gjitha çështjet që mund të kërkojnë, në formën dhe në intervalet e parapara nga Zyra e Rregullatorit për Energji.

3. Operatori i Sistemit të Transmisionit do të përgatitë dhe rishikojë Kodin e Rrjetit, dhe gjatë realizimit të kësaj do konsultohet sipas nevojës me operatorë dhe sisteme tjera me të cilat është i lidhur. Operatori i Sistemit të Transmisionit duhet t'ia parashtrojë Kodin e Rrjetit dhe të gjitha ndryshimet në të për miratim Zyrës së Rregullatorit për Energji

4. Kodi i Rrjetit duhet të mbulojë të gjitha çështjet që mund të specifikohen nga Zyra e Rregullatorit për Energji, përfshirë:

4.1. rregullat minimale për siguri, planifikim, dizajnim dhe operim të sistemit të transmisionit, përfshirë obligimet për mirëmbajtje të një niveli të duhur të sigurisë së sistemit dhe kapaciteteve rezervë;

4.2. rregullat teknike që përcaktojnë dizajnin minimal teknik dhe kriteret operative për kyçe në sistem dhe interkonektorë dhe për operimin e sistemeve të tjera;

4.3. kriteret teknike dhe ekonomike që do shfrytëzohen gjatë dispeçimit të prodhimit vendor ose të importuar sipas nenit 9 të këtij ligji, duke marrë parasysh përparësitë ekonomike të energjisë elektrike nga gjeneratorët e instaluar në dispozicion apo transferet në interkonektorë, kufizimet teknike të sistemit, dhe qëndrueshmërinë e duhur të furnizimit; dhe

4.4. procedurat e zbatueshme për operim të sistemit në situata pasigurie.

5. Kodi i Rrjetit do të publikohet dhe do të sigurojë ndërveprimin e sistemeve, do të jetë objektiv dhe jodiskriminues dhe do të zbatohet në mënyrë objektive dhe jodiskriminuese.

6. Operatori i Sistemit të Transmisionit do të monitorojë implementimin e Kodit të Rrjetit dhe do të raportojë në baza vjetore mbi implementimin e tij tek Zyra e Rregullatorit për Energji.

7. Operatori i Sistemit të Transmisionit është përgjegjës të faturojë dhe inkasojë pagesat që i detyrohen palët tjera sipas kontratave të lidhura dhe për shërbimet tjera të siguruar, përfshirë edhe shpenzimet e ndërlidhura me pjesëmarrjen e tij në organizata ndërkombëtare, pjesëmarrje kjo që mund të kushtëzohet nga marrëveshjet ndërkombëtare apo rregulloret ndërkombëtare të zbatueshme për Kosovën. Kushtet dhe konditat, përfshirë rregullat dhe tarifën, për ofrimin e shërbimeve nga Operatori i Sistemit të Transmisionit do të përcaktohen në mënyrë jodiskriminuese dhe që i pasqyrojnë shpenzimet, do t'i nënshtrohen miratimit nga Zyra e Rregullatorit për Energji dhe do të publikohen.

Neni 13

Sigurimi i Energjisë Elektrike nga Operatori i Sistemit të Transmisionit

1. Operatori i Sistemit të Transmisionit do të prokurorë të gjitha sasitë e energjisë, kapaciteteve rezervë, dhe shërbimeve tjera ndihmëse që nevojiten për operim efikas të sistemit të transmisionit, në bazë të procedurave transparente, jodiskriminuese dhe të bazuara në treg.

2. Të gjitha rregullat për balancimin e sistemit të energjisë elektrike duhet të jenë objektive, transparente dhe jodiskriminuese, duke përfshirë edhe të gjitha rregullat për detyrimet e përdoruesve të sistemit për mosbalancimin energjetik. Të gjitha këto rregulla dorëzohen për miratim nga Operatori i Sistemit të Transmisionit në Zyrën e Rregullatorit për Energji.

Neni 14

Informatat konfidenciale

1. Operatori i Sistemit të Transmisionit duhet të ruajë fshehtësinë e informatave konfidenciale të cilat vjen gjatë kryerjes së aktiviteteve të veta. Publikimi apo zbulimi nga Operatori i Sistemit të Transmisionit i informacioneve lidhur me veprimtarinë e tij që mund t'i sjell përparësi ose përfitim ndonjë personi tjetër, duhet të kryhet në mënyrë jodiskriminuese.

2. Pavarësisht nga paragrafi 1. i këtij neni, Ministria apo Zyra e Rregullatorit për Energji mund t'i kërkojnë Operatorit të Sistemit të Transmisionit që t'u sigurojë Ministrisë apo Zyrës së Rregullatorit për Energji informacionin konfidencial i cili është i domosdoshëm për t'i kryer funksionet, autorizimet dhe detyrat e tyre.

KREU V

SHPËRNDARJA E ENERGJISË ELEKTRIKE

Neni 15

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes

1. Qeveria e Republikës së Kosovës sipas procedurave të hapura dhe konkurruese do të emërojë një apo më shumë persona juridikë si kandidatë për tu bërë Operatorë të Sistemit të Shpërndarjes. Secili kandidat duhet të aplikojë pas emërimit nga Qeveria për licencim tek Zyra e Rregullatorit për Energji. Të gjithë operatorët e sistemit të shpërndarjes do të mbajnë në pronë dhe do të jenë përgjegjës për operimin e sistemeve të tyre përkatëse të shpërndarjes.

2. Kur Operatori i Sistemit të Shpërndarjes është pjesë e ndonjë ndërmarrjeje të integruar të energjisë elektrike, ai do të jetë i pavarur nga të gjitha veprimtaritë tjera që nuk ndërlidhen me shpërndarjen, së paku sa i përket formës juridike, organizimit apo vendimmarrjes.

3. Për të siguruar pavarësinë e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, kriteret minimale në vijim duhet të zbatohen dhe të inkorporohen në licencën e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes:

3.1. personat përgjegjës për menaxhimin e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes nuk guxojnë të jenë pjesëmarrës në strukturat e kompanive të ndërmarrjeve të integruara vertikalisht të energjisë elektrike përgjegjëse, drejtpërsëdrejti apo tërthorazi, për operimin ditor të prodhimit, transmisionit apo furnizimit të energjisë elektrike;

3.2. masa të përshtatshme duhet të ndërmerren për t'u siguruar se interesat profesionalë të personave përgjegjës për menaxhimin e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes janë marrë në konsideratë në mënyrë që siguron se ata janë të aftë të veprojnë në mënyrë të pavarur;

3.3. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të ketë të drejta efektive vendimmarrëse, në mënyrë të pavarur nga ndërmarrjet e integruara vertikalisht të energjisë elektrike, sa i përket aseteve të domosdoshme për të operuar, mirëmbajtur dhe zhvilluar sistemin.

3.4. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të ketë në dispozicion të gjitha resurset e nevojshme, përfshirë ato njerëzore, teknike, fizike dhe financiare.

3.5. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes harton dhe Zyra e Rregullatorit të Energjisë do të miratojë një program të pajtueshmërisë i cili përcakton masat të cilat duhet të ndërmerren për eliminimin e sjelljeve diskriminuese dhe të sigurojë që programi të monitorohet në mënyrë adekuate. Programi do të përcaktojë detyrimet specifike të punonjësve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes për

arritjen e këtij objektivi. Një raport vjetor publik i cili përshkruan masat të cilat janë ndërmarrë do të dorëzohet nga personi ose organi përgjegjës për monitorimin e programit të pajtueshmërisë në Zyrën e Rregullatorit për Energji.

4. Dispozitat e këtij neni nuk duhet të pengojnë ekzistencën e mekanizmave të përshtatshëm të koordinimit për të siguruar që të drejtat e mbikëqyrjes ekonomike dhe menaxheriale të kompanisë amë sa i përket fitimit nga asetet, të rregulluara në mënyrë të tërthortë në pajtim me dispozitat relevante, mbi kompaninë vartëse. Në veçanti, kjo do t'i mundësojë kompanisë amë të miratojë planin financiar vjetor apo instrumentet ekuivalente të operatorit të sistemit të shpërndarjes dhe të përcaktojë limitet e përgjithshme mbi nivelet e borxheve të kompanisë vartëse. Kompania amë nuk do të lejohet të japë udhëzime sa i përket funksionimit të përditshëm apo sa i përket vendimeve individuale lidhur me ndërtimin apo përmirësimin e linjave të shpërndarjes, nëse këto nuk tejkalojnë termat e parapara me planin financiar të miratuar apo me instrumentet tjera ekuivalente.

5 Në rastet kur Operatori i Sistemit të Shpërndarjes është pjesë e një ndërmarrjeje të integruar vertikalisht të energjisë elektrike, veprimtaria e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes do të monitorohet nga Zyra e Rregullatorit për Energji , në mënyrë që të mos ti shfrytëzoj avantazhet për çrregullimin e konkurrencës. Në veçanti, në rastet kur Operatori i Sistemit të Shpërndarjes është pjesë e një ndërmarrjeje të integruar vertikalisht të energjisë elektrike, ai nuk do të krijojë konfuzion, gjatë komunikimit dhe shfrytëzimit të shenjave mbrojtëse, sa i përket identitetit të ndarë të degës së furnizimit dhe ndërmarrjes së integruar vertikalisht të energjisë elektrike.

6. Në rastet kur bazuar në raportin e dorëzuar apo në informatat tjera, Zyra e Rregullatorit për Energji nuk është e bindur se Operatori i Sistemit të Shpërndarjes është duke vepruar plotësisht në pajtim me dispozitat e paragrafëve 3. dhe 5. të këtij neni, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do t'i sigurojë Zyrës së Rregullatorit për Energji me shpejtësi të gjitha informatat tjera që mund të kërkohen nga ajo. Në rastet kur konsiderohet i domosdoshëm sigurimi i pajtueshmërisë me paragrafët 3. dhe 5. të këtij neni, Zyra e Rregullatorit për Energji do të ndërmarrë çfarëdo veprime tjera të nevojshme për të siguruar pajtueshmëri me këto dispozitat përkatëse dhe me licencën e operatorit të sistemit të shpërndarjes.

Neni 16

Përgjegjësitë dhe të Drejtat e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes

1. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të jetë përgjegjës për:

1.1. sigurimin e disponueshmërisë afatgjatë të sistemit për të përmbushur kërkesat e arsyeshme për shpërndarje të energjisë elektrike, për operimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin sipas kushteve të tregut të një sistemi të sigurt, të qëndrueshëm dhe efikas shpërndarës të energjisë elektrike brenda zonës së vet, duke i kushtuar kujdes të duhur mjedisit dhe efijencës së energjisë;

1.2. ofrimin e kyçjeve në pajtim me këtë ligj, për të gjithë konsumatorët shtëpiakë që kërkojnë atë;

1.3. ofrimin e kyçjeve në pajtim me këtë ligj, për të gjithë konsumatorët jo shtëpiakë që kërkojnë atë, përveç në rastet kur nuk është teknikisht apo ekonomikisht e arsyeshme që ajo të realizohet;

1.4. të siguroar mos diskriminim mes shfrytëzuesve të sistemit apo kategorive të shfrytëzuesve të sistemit, në veçanti duke mos i favorizuar vartësit apo aksionarët;

1.5. të vepruar në pajtim me të gjitha standardet e sigurisë e kualitetit të furnizimit dhe sigurisë së sistemit të shpërndarjes të cilat janë të përcaktuara nga Zyra e Rregullatorit për Energji;

1.6. të siguroar se ndërprerja e furnizimit në situata emergjente bazohet në kritere të parapërcaktuara dhe objektive, dhe për të siguroar se do të ndërmerren konsultime mbi ndërprerjet me ndërmarrjet tjera të energjisë elektrike dhe Zyrën e Rregullatorit për Energji;

1.7. t'i siguroar shfrytëzuesve të sistemit informatat që u duhen për të ushtruar qasje efikase në sistem përfshirë edhe shfrytëzimin e tij;

1.8. t'i dhënë prioritet dispeçimit të energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e ripërtëritshme të energjisë dhe bashkëprodhimi, me kusht që të mos i tejkalojë limitet e sigurisë së sistemit të specifikuar në Kodin e Rrjetit, Kodin e Shpërndarjes apo në rregullat e rregulloret tjera;

1.9. caktimin dhe publikimin e rregullave standarde mbi atë se kush bartë shpenzimet për adaptime teknike në sistemin e vet shpërndarës, siç janë kyçjet në rrjet apo përforcimet e rrjetit, që janë të domosdoshme për të integruar në sistem stabilimentet e reja të prodhimit të energjisë elektrike. Këto rregulla duhet t'i dorëzohen për miratim Zyrës së Rregullatorit për Energji, do të jenë në pajtim me Strategjinë për Energji dhe do të bazohen në kritere objektive, transparente dhe jodiskriminuese, duke marrë në konsideratë të veçantë të gjitha shpenzimet dhe përfitimet e ndërlidhura me kyçjen e prodhuesve të tillë në sistem;

1.10. t'i siguroar të gjithë prodhuesve të rinj që duan të lidhen në rrjetin e sistemit të shpërndarjes parashikime gjithëpërfshirëse dhe të detajuara të shpenzimeve të ndërlidhura me kyçjen, për të cilat parashikime Operatori i Sistemit të Shpërndarjes mund të kërkojë një pagesë që pasqyron shpenzime të arsyeshme.

1.11. të përcaktuar dhe publikuar rregulla standarde sa i përket ndarjes së shpenzimeve për instalime në sistem, siç janë kyçjet në rrjet dhe përforcimet e rrjetit, mes të gjithë shfrytëzuesve të sistemit që përfitojnë nga ai. Këto rregulla duhet t'i dorëzohen për miratim Zyrës së Rregullatorit për Energji dhe do të jenë në pajtim me Strategjinë për Energji dhe të gjitha aktet tjera nënligjore të zbatueshme;

1.12. të planifikuar dhe realizuar zhvillimin e sistemit të vet shpërndarës, duke marrë parasysh masat e efijencës së energjisë apo prodhimin e shpërndarë që mund të zëvendësojë nevojën për përmirësim apo zëvendësim të kapaciteteve të energjisë elektrike;

1.13. hartimin dhe publikimin e planeve afatmesme dhe afatgjata, që mbulojnë periudha prej së paku tre vite respektivisht dhjetë vite, për zhvillimin e sistemit të shpërndarjes dhe koordinimin e përgatitjes së këtyre planeve me Operatorin e Sistemit të Transmisionit dhe komunat;

1.14. zhvillimin dhe propozimin e tarifave dhe metodologjive tarifore për shfrytëzimin dhe kyçjen në sistemin e shpërndarjes, të cilat janë jo diskriminuese dhe që ofrojnë sinjale efikase ekonomike për shfrytëzuesit e sistemit; çdo propozim i këtillë do të dorëzohet në Zyrën e Rregullatorit të Energjisë për miratim dhe publikim në pajtim me rregullat dhe procedurat e përcaktuara në Kreun IX të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;

1.15. studimin e zhvillimit ekonomik dhe kërkimin e ndryshimeve në territorin e vet;

1.16. asistimin e komunave në përgatitjen e planeve, programeve dhe strategjive zhvillimore të tyre;

1.17. vënien në dispozicion për Operatorin e Sistemit të Transmisionit të kopjeve të planeve zhvillimore afatmesme dhe afatgjate për sistemin e tij të shpërndarjes; dhe

1.18. pajtueshmërinë me Kodin e Rrjetit, Kodin e Shpërndarjes dhe të gjitha kodet dhe rregullat tjera në fuqi.

2. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do t'i raportojë Zyrës së Rregullatorit për Energji, siç përcaktohet në licencën e tij dhe me Ligjin e Rregullatorit për Energji, dhe do t'i ofrojë asaj informata mbi çështjet që mund të kërkohen, në formën dhe intervalet kohore të përcaktuara nga Zyra e Rregullatorit për Energji.

3. Operatori i sistemit të shpërndarjes përpilon dhe rregullisht shqyrton Kodin e Shpërndarjes për sistemin e tij, në konsultim përkatës me operatorët e sistemeve të tjera me të cilët është i lidhur. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes dorëzon Kodin e Shpërndarjes dhe ndryshimet e mundshme për miratim te Zyra e Rregullatorit për Energji.

4. Kodi i Shpërndarjes mbulon çështjet që mund t'i specifikojë Zyra e Rregullatorit për Energji, të cilat përfshijnë:

4.1. rregullat minimale për zhvillimin dhe Operimin e Sistemit të Shpërndarjes, përfshirë obligimet për mirëmbajtjen e një niveli të duhur të sistemit të sigurisë dhe kapacitetit rezervë;

- 4.2. rregullat teknike që përcaktojnë kriteret minimale për dizajnin teknik dhe ato operacionale për kyçe me sistemin dhe interkoneksionin, si dhe operimin e sistemeve tjera;
- 4.3. procedurat e aplikueshme për operatorët e sistemit në situata emergjente.
5. Kodi i Shpërndarjes bëhet publik dhe është objektiv dhe jodiskriminues; si dhe zbatohet në mënyrë objektive dhe jo diskriminuese.
- 6 Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të monitorojë implementimin e Kodit të Shpërndarjes dhe do të raportojë në baza vjetore mbi implementimin e tij tek Zyra e Rregullatorit për Energji.
7. Operatori i Sistemit të shpërndarjes ka të drejtë të faturojë dhe inkasojë pagesat në pajtim me kontratat e tij si dhe për të gjitha shërbimet tjera të ofruara. Afatet dhe kushtet, përfshirë rregullat dhe tarifën, për ofrimin e shërbimeve nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes përcaktohen në mënyrë jo diskriminuese dhe duke pasqyruar kostot, i nënshtrohen miratimit nga Zyra e Rregullatorit për Energji, si dhe bëhen publike.
8. Operatori i sistemit të shpërndarjes prokuron energjinë e kërkuar për operim efikas të sistemit të tij të shpërndarjes, si dhe mirëmbajtjet apo shërbimet tjera të duhura në pajtim me procedurat transparente, jo diskriminuese dhe të bazuara në treg.

Neni 17

Informatat konfidenciale

1. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes ruan fshehtësinë e informatave konfidenciale të cilat i arrin gjatë kryerjes së aktiviteteve të veta. Publikimi apo shpalosjet tjera të informacioneve që ndikojnë në veprimtarinë e tij e që mund t'i sjellin përparësi ose përfitim duhet të kryhet në mënyrë jodiskriminuese.
2. Pavarësisht paragrafit 1. të këtij neni, Ministria ose Zyra e Rregullatorit për Energji mund t'i kërkojë Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes që t'i sigurojë Ministrisë ose Zyrës së Rregullatorit për Energji informacionin konfidencial i cili është i domosdoshëm për t'i kryer funksionet, autorizimet dhe detyrat e tyre.

KREU VI

FURNIZIMI ME ENERGJI ELEKTRIKE

Neni 18

Furnizuesi publik

1. Furnizuesi publik do të kryejë detyrimin e shërbimit publik të ofrimit të energjisë elektrike me tarifa të rregulluara për konsumatorët e pakualifikuar. Rregullimi i tarifave do të bëhet në pajtim me nenin 41 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë. Furnizuesi publik është një ndërmarrje me licencë të Zyrës së Rregullatorit për Energji për kryerjen e furnizimit publik me energji elektrike, dhe nuk mund të jetë prodhues i energjisë elektrike.

2. Furnizuesi publik ka të drejtë të:

2.1. shetë ekskluzivisht, energji elektrike konsumatorëve tariforë, në pajtim me kushtet dhe afatet e licencës dhe kushtet e afatet tjera të aplikueshme;

2.2. furnizojë me energji elektrike konsumatorët e kualifikuar, në qoftë se një gjë e tillë kërkohet nga konsumatori, në pajtim me licencën e tij dhe kushtet tjera të aplikueshme;

2.3. blejë energji elektrike nga prodhuesit e energjisë elektrike me çmime të rregulluara, në pajtim me nenin 7 të këtij ligji dhe nenin 41 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;

2.4. blejë kapacitete dhe energji elektrike nga prodhuesit apo furnizuesit e tjerë në çmime të parregulluara;

2.5. shesë kapacitete dhe energji elektrike për ndërmarrjet tjera të energjisë elektrike të licencuara, në pajtim me procedurat e specifikuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji, në rast se kërkesa e konsumatorëve të tij për energji elektrike zvogëlohet nën nivelin për të cilin është kontraktuar;

2.6. importojë kapacitete dhe energji elektrike në pajtim me paragrafin 3. të këtij neni;

2.7. eksportojë kapacitete dhe energji elektrike në rastet kur kërkesat e konsumatorëve janë më të vogla se kapaciteti i kontraktuar; dhe

2.8. përgatitë dhe dorëzon faturat si dhe arkëton pagesat nga konsumatorët e tij dhe ndërmarrjet tjera energjetike. Ky faturim dhe inkasim monitorohet nga Zyra e Rregullatorit për Energji, sipas përcaktimit të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë apo ligjet tjera të aplikueshme, si dhe licencat, kodet apo rregullat që lëshohen nga to.

3. Duke përjashtuar obligimet e ndërmarrjes në pronësi publike të përcaktuara në paragrafin 1. të nenit 38 të këtij ligji, Furnizuesi Publik ka obligimin e përgjithshëm që të sigurojë një furnizim të qëndrueshëm të energjisë elektrike për përmbushjen e nevojave të konsumatorëve të pa kualifikuar nga burime vendore ose jo-vendore.

4. Furnizuesi publik mund të lidhë marrëveshje për blerjen e energjisë elektrike me prodhuesit e energjisë elektrike në pajtim me legjislacionin e aplikueshëm për konkurrencën dhe ndihmën shtetërore.

5. Kur një marrëveshje për shitjen e energjisë elektrike e lidhur sipas paragrafit 4. të këtij neni parashikon shitjen e energjisë elektrike me çmime të rregulluara, Zyra e Rregullatorit të Energjisë ka të drejtë të aprovojë çdo propozim nga palët për ndryshimin e metodologjisë ose bazës sipas të cilën çmimet fillestare (ose komponentët e atyre çmimeve) janë llogaritur, ose propozimet për ndryshimin e metodologjisë përmes së cilës bëhet rregullimi në bazë vjetore ose në bazë tjetër i atyre çmimeve (ose komponentëve të atyre çmimeve). Neni 41 i Ligjit për Rregullatorin e Energjisë mbetet i pa ndikuar.

6. Furnizuesi publik do të:

6.1. furnizojë energji elektrike për të gjithë konsumatorët e jokualifikuar që kërkojnë një gjë të tillë;

6.2. furnizojë energji elektrike për konsumatorët e kualifikuar nëse kërkohen për të bërë një gjë të tillë, me kusht që ky furnizim bëhet vetëm në tarifa të rregulluara të përcaktuara nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë për konsumatorë të tillë të kualifikuar, si dhe sipas kushteve që mund t'i përcaktojë Zyra e Rregullatorit për Energji;

6.3. blejë me prioritet, çfarëdo kapaciteti dhe energji elektrike për të cilën është lëshuar certifikata e origjinës nga Zyra e Rregullatorit për Energji në tarifë të rregulluar të përcaktuar apo të zhvilluar sipas metodologjisë së miratuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji;

6.4. krijojë, pas konsultimit me Zyrën e Rregullatorit të Energjisë, mekanizmat e nevojshëm për përkrahjen e konsumatorëve në nevojë në mënyrë që ata të mund t'i shmangen shkyçjes për mos pagesë të faturave të energjisë elektrike

6.5. shqyrtojë të gjitha ankesat e konsumatorëve të tij në mënyrë efektive, si dhe trajtimi i këtyre ankesave do të monitorohet nga Zyra e Rregullatorit për Energji, siç përcaktohet me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë apo ligjet tjera të aplikueshme apo rregullat tjera që lëshohen nga Zyra e Rregullatorit për Energji, dhe

6.6. të sigurojë garanci financiare për të mbuluar të gjitha transaksionet që i ndërmerr përkitazi me tregun e energjisë elektrike. Kërkesat për formën, llojin dhe shumën e garancionit financiar përcaktohen në rregullat e tregut të energjisë elektrike; dhe

- 6.7. kur është përcaktuar si furnizues i burimit të fundit nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë, të kryejë këto detyra siç mund të jenë përcaktuar në licencën e tij, si dhe ka të drejtën e kthimit të të gjitha kostove shtesë të shkaktuara si rezultat i kryerjes efikase të këtyre detyrave në pajtim me paragrafin 4. të nenit 16 të Ligjit për Energjinë.
7. Furnizuesi publik obligohet që të sigurojë informata të rregullta për konsumatorët e tij mbi çështjet që kanë të bëjnë me furnizimin e tyre me energji, përfshirë edhe çështjet mjedisore. Informatat e siguruara duhet të jenë në pajtim me kërkesat e Zyrës së Rregullatorit për Energji, dhe furnizuesi publik siguron së bashkë me faturat, dhe në materialet promovuese për konsumatorët e fundit, përfshihen edhe:
- 7.1. kontributi i çdo burimi të energjisë në përzierjen e përgjithshme të lëndës djegëse të furnizuesit publik gjatë vitit paraprak;
 - 7.2. së paku referencë në burimet ekzistuese të referencës, siç janë faqet e internetit, ku gjenden në dispozicion informata mbi ndikimet mjedisore, që së paku tregojnë lirimet e CO2 dhe mbeturinave radioaktive si rrjedhojë e prodhimit të energjisë elektrike nga përzierja e përgjithshme e lëndës djegëse të furnizuesit gjatë vitit paraprak; dhe
 - 7.3. informata mbi të drejtat e konsumatorëve për sa i përket masave të zgjidhjes së kontesteve që janë në dispozicion të tyre në rast të kontesteve.
8. Furnizuesi publik lidhë kontrata me të gjithë konsumatorët e fundit të cilëve u ofron furnizim me energji elektrike. Këto kontrata janë në pajtim me Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me energji elektrike dhe me kërkesat e nenit 27 të këtij ligji.
9. Secili person që kyçet në sistemin e shpërndarjes dhe shfrytëzon energjinë elektrike të furnizuar nga furnizuesi publik pa kontratë, siç saktësohet me këtë nen, do të shkyçet nga sistemi i shpërndarjes në pajtim me rregullat mbi shkyçjet të përcaktuara nga Zyra e Rregullatorit për Energji.
10. Furnizuesi publik mund të rregullojë kyçjen në një pajisje matëse për hapësirat e përbashkëta vetëm nëse një person fizik a juridik nënshkruan kontratë me furnizuesin publik dhe pranon të paguajë për të gjitha kapacitetet, energjinë, shërbimet e shpërndarjes dhe shërbimet e transmisionit të furnizuara përmes asaj pajisje matëse.
11. Zyra e Rregullatorit për Energji mund të rregullojë afatet e kushtet sipas të cilave çdo konsumator i furnizuesit publik përgjegjës për pagesën për energjinë elektrike të regjistruar nga pajisja matëse që furnizon hapësirat e përbashkëta mund të vë taksa për personat të tjerë të cilët përfitojnë nga ajo energji elektrike.
12. Zyra e Rregullatorit të Energjisë do të sigurojë që aftësia e furnizuesit publik për përmbushjen e detyrimeve të pagesës ndaj një prodhuesi sipas një marrëveshje për blerjen e energjisë elektrike të mos zvogëlohet në rast se konsumatorët e kualifikuar vendosin të furnizohen nga furnizuesit tjerë aktiv në tregun konkurrues. Për këtë qëllim, Zyra e

Rregullatorit të Energjisë mund të krijojë mekanizma, siç është mekanizmi për lëshimin e energjisë elektrike i përcaktuar në nenin 25 të këtij ligji.

13. Furnizuesi publik, për së paku pesë (5) vite, mban në dispozicion të dhënat relevante që kanë të bëjnë me të gjitha transaksionet e kontratave për blerje të energjisë elektrike, furnizim me energji elektrike dhe të derivativave të energjisë elektrike me konsumatorët me shumicë dhe Operatorin e Sistemit të Transmisionit, për Zyrën e Rregullatorit për Energji, Komisionin Kosovar për Konkurrencë dhe autoritetet tjera kompetente në Komunitetin e Energjisë, me qëllim të përmbushjes së detyrave të tyre.

14. Të dhënat e referuara në paragrafin 13. të këtij neni përfshijnë hollësi mbi karakteristikat e transaksioneve relevante siç janë kohëzgjatja, dërgimi dhe rregullat e zgjidhjes, sasinë dhe kohët e ekzekutimit, si dhe çmimet e transaksionit dhe masat e identifikimit të konsumatorëve në fjalë të blerjes me shumicë, dhe hollësi të specifikuara të gjitha kontratave të papërfunduara të furnizimit me energji elektrike dhe derivativave të energjisë elektrike.

15. Zyra e Rregullatorit për Energjisë mund të vendosë që të ofrojë në dispozicion për pjesëmarrësit e tregut elemente të informatave të referuara në paragrafin 16. të këtij neni, me kusht që nuk lëshohen informatat e ndjeshme komerciale mbi akterët individualë të tregut apo transaksionet relevante.

16. Zyra e Rregullatorit për Energji ndërmerr të gjithë hapat e domosdoshëm për të siguruar se informatat e ofruara nga furnizuesi publikë për konsumatorët e tyre në pajtim me këtë nen janë të besueshme dhe se sigurohen në nivel shtetëror në mënyrë të qartë të krahasueshme.

Neni 19

Konsumatorët e kualifikuar

1. Furnizimi me energji elektrike është aktivitet konkurrues dhe çdo ndërmarrje e kualifikuar, qoftë vendore apo e huaj, mund të aplikojë për të marrë licencë për furnizimin e konsumatorëve të kualifikuar sipas këtij neni, në pajtim me kriteret tjera të përcaktuara nga Zyra e Rregullatorit për Energji.

2. Zyra e Rregullatorit për Energji siguron se janë në funksion rregullimet efektive për t'iu mundësuar konsumatorëve të kualifikuar që të ndërrojnë furnizuesin sa më thjeshtë që është e mundur, jo më vonë se tri (3) javë pas njoftimit të furnizuesit të tyre aktual, se nuk ka pagesa për ndërrimet të tilla, dhe se konsumatorët e mëdhenj jo shtëpiak kanë të drejtë të kontraktimit të njëkohshëm me disa furnizues.

3. Konsumatorët që kanë fituar statusin e konsumatorit të kualifikuar në kohën kur ky ligj hyn në fuqi, do të vazhdojnë të kenë këtë status.

4. Të gjithë konsumatorët përveç konsumatorëve shtëpiak janë konsumator të kualifikuar. Të gjithë konsumatorët do të jenë konsumator të kualifikuar më 1 janar 2015.

5. Furnizuesi publik mund të furnizojë me energji elektrike konsumatorët e kualifikuar vetëm në pajtim me nenin 18 të këtij ligji.

6. Ndryshimi i furnizuesit nga Konsumatorët e Kualifikuar do të bëhet në pajtim me procedurat e përcaktuara në Rregullat e Tregut të miratuara nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë.

Neni 20

Furnizimi për Konsumatorët e Kualifikuar

1. Furnizimi me energji elektrike për konsumatorët e kualifikuar mund të bëhet nga të gjithë personat që posedojnë licencë për furnizim të lëshuar nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë.

2. Kushtet dhe afatet e licencës së për furnizim të kualifikuar përcaktohen nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë, të cilat kërkojnë që furnizuesi të jetë me reputacion të qëndrueshëm dhe të ketë kontrata blerjeje, që mbështesin aktivitetet e tij të furnizimit. Zyra e Rregullatorit të Energjisë siguron se procedurat e licencimit dhe kushtet e licencimit nuk diskriminojnë ndërmarrjet e furnizimit të cilat tanimë janë të regjistruara në një shtet tjetër brenda Komunitetit të Energjisë, pavarësisht shtetit në të cilin është i regjistruar furnizuesi.

3. Ndërmarrja e energjisë elektrike e licencuar për furnizimin e konsumatorëve të kualifikuar (përveç bartësit të licencës për furnizim publik) ka të drejtë të:

3.1. shesë kapacitet dhe energji elektrike konsumatorëve të kualifikuar me çmime të parregulluara;

3.2. blejë kapacitet dhe energji elektrike nga prodhues me çmime të parregulluara;

3.3. blejë dhe shesë kapacitet dhe energji elektrike nga furnizues të tjerë me çmime të parregulluara;

3.4. blejë kapacitet dhe energji elektrike nga furnizuesi publik në pajtim me dispozitat e nenit 18 të këtij ligji;

3.5. importojë dhe eksportojë kapacitet dhe energji elektrike; dhe

3.6. faturtojë dhe mbledhë pagesat nga konsumatorët e kualifikuar dhe furnizuesit tjerë.

4. Ndërmarrja e energjisë elektrike e licencuar për furnizim, e cila furnizon edhe konsumatorët e kualifikuar do t'i ndërmerr hapat e nevojshëm për mbrojtjen e interesave të konsumatorëve të saj dhe ka për obligim trajtimin efektiv të të gjitha ankesave të konsumatorëve të saj. Shqyrtimin i ankesave të tilla monitorohet nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë, në pajtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë apo ligjet tjera të

aplikueshme, si dhe licencat, kodet apo rregullat që lëshohen nga Zyra e Rregullatorit për Energji.

5. Ndërmarrja e energjisë elektrike e licencuar për furnizim, e cila furnizon edhe konsumatorët e kualifikuar ofron informata të rregullta për konsumatorët e saj mbi çështjet që kanë të bëjnë me furnizimin e tyre me energji elektrike, përfshirë çështjet mjedisore. Informatat që do të sigurohen janë në pajtim me kërkesat e Zyrës së Rregullatorit për Energji, si dhe furnizuesi i licencuar siguron se me fatura, dhe në materialet promovuese që ofrohen në dispozicion për konsumatorët fundor përfshihen si në vijim:

5.1. kontributi i çdo burimi të energjisë në përzierjen e përgjithshme të lëndës djegëse të furnizuesit të licencuar gjatë vitit paraprak;

5.2. së paku referencë në burimet ekzistuese të referencës, siç janë faqet e internetit, ku gjenden në dispozicion informata mbi ndikimet mjedisore, që së paku tregojnë lirimet e CO₂ dhe mbeturinave radioaktive si rrjedhojë e prodhimit të energjisë elektrike nga përzierja e përgjithshme e lëndës djegëse të furnizuesit gjatë vitit paraprak; dhe

5.3. informata mbi të drejtat e konsumatorëve për sa i përket masave të zgjidhjes së kontesteve që janë në dispozicion të tyre në rast të kontesteve.

6. Zyra e Rregullatorit për Energji ndërmerr hapat e nevojshëm për të siguruar se informatat e siguruar nga furnizuesit për konsumatorët e tyre në pajtim me paragrafin 5. të këtij neni janë të besueshme dhe se në nivel shtetëror sigurohen në mënyrë të qartë të krahasueshme.

7. Ndërmarrja e energjisë elektrike e licencuar për furnizim, e cila furnizon edhe konsumatorët e kualifikuar paraqet garancinë financiare për mbulimin e të gjitha transaksioneve që i ndërmerr në lidhje me tregun e energjisë elektrike. Kërkesat mbi formën, llojin dhe shumën e garancisë financiare përkufizohen në rregullat e energjisë elektrike.

8. Ndërmarrjet e energjisë elektrike të licencuara për furnizim, të cilat furnizojnë edhe konsumatorët e kualifikuar zbatojnë dispozitat e paragrafëve 13., 14. dhe 15. të nenit 18 të këtij ligji përkitazi me mbajtjen e regjistrit të shënimeve.

Neni 21 **Linjat direkte**

1. Të gjithë prodhuesit e energjisë elektrike në Kosovë do të kenë mundësinë të lidhin stabilimentet e tyre, apo stabilimentet e njësisve të tyre, apo të konsumatorëve të kualifikuar, nëpërmjet linjave direkte.

2. Të gjithë konsumatorët e kualifikuar në Kosovë do të kenë të drejtën të furnizohen nga një linjë direkte aty ku është e mundur nga aspekti teknik dhe ekonomik.

3. Autorizimet për ndërtimin e linjave direkte lëshohen nga Zyra e Rregullatorit për Energji në bazë të kriterëve objektive dhe jodiskriminuese të publikuara paraprakisht e që kanë të bëjnë me sigurinë, efikasitetin dhe integritetin e sistemeve të transmisionit dhe shpërndarjes. Zyra e Rregullatorit për Energji mund të refuzojë dhënien e autorizimit për ndërtimin e një linje direkte nëse dhënia e autorizimit e parandalon ose pengon një detyrim të shërbimit publik të vendosur nga Zyra e Rregullatorit për Energji sipas Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.

4. Nëse një konsumator i kualifikuar pranon furnizim përmes linjës direkte, kjo nuk do të ndikojë në të drejtën e tij të kontraktimit të furnizuesit të zgjedhur dhe të pranimit të furnizimit përmes sistemit të transmisionit ose sistemit të shpërndarjes në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

KREU VII QASJA E PALËS SË TRETË

Neni 22 E drejta e qasjes të palës së tretë

1. Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes duhet t'i lejojë prodhuesit, furnizuesit, dhe konsumatorit të kualifikuar të kenë qasje në sistemin e transmisionit dhe në sistemin e shpërndarjes në bazë të tarifave të publikuara, si dhe rregullave dhe procedurave të specifikuara nga Zyra e Rregullatorit për Energji, Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes.

2. Gjatë përcaktimit se në çfarë mase do të lejohen kërkesat për qasje në sistemin e transmisionit dhe shpërndarjes, Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes sigurojnë se e vënë në dispozicion kapacitetin maksimal të sistemeve të tyre, përfshirë interkonektorët, në pajtim me standardet e zbatueshme të sigurisë dhe nevojën për operim të sigurt të sistemit.

3. Tarifat për përdorim të sistemit janë objektive dhe aplikohen për të gjithë konsumatorët në baza jodiskriminuese. Këto tarifa propozohen në baza vjetore nga Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, sipas mënyrës së përshkruar nga Zyra e Rregullatorit për Energji, si dhe ato nuk hyjnë në fuqi deri në miratimin nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë dhe publikimit të tyre. Tarifat e propozuara përfshijnë sinjale të duhura ekonomike për inkurajimin e përdorimit efikas të sistemeve dhe interkonektorëve.

Neni 23

Refuzimi i qasjes të palës së tretë

1. Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes mund të refuzojnë qasjen në sistemin e transmisionit dhe të shpërndarjes nëse nuk ka në dispozicion kapacitete të nevojshme, dhe nëse mungesa e kapaciteteve arsyetohet në bazë të sigurisë së furnizimit, ose cilësisë së furnizimit, duke marrë parasysh standardet e shërbimit dhe besueshmërinë e kërkuar nga personi që mëton qasje, si dhe të gjitha kodet dhe rregullat në fuqi.
2. Të gjitha arsyet për refuzim të qasjes sipas paragrafit 1. të këtij neni paraqiten në raportin me shkrim me faktet mbështetëse, dhe u jepen personit që kërkon të lidhë kontratë për qasje në sistem. Po ashtu, personit që kërkon qasje do t'i ofrohen informata mbi masat e nevojshme për përforcimin e rrjetit për lejimin e qasjes, përveç që operatori relevant i sistemit mund të kërkojë pagesë të arsyeshme që pasqyron kostot e ofrimit të informatave të tilla.
3. Çdo personi të cilit i refuzohet qasja në sistemin e transmisionit apo të shpërndarjes apo i cili kundërshton kushtet e imponuara për qasje, mund të parashtojë ankesë në Zyrën e Rregullatorit për Energji, e cila merr vendim në përputhje me procedurat e parapara në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë.

KREU VIII

TREGU I ENERGJISË ELEKTRIKE

Neni 24

Operatori i Tregut

1. Qeveria është përgjegjëse për përzgjedhjen e Operatorit të Tregut përmes një procesi të hapur.
2. Operatori i Tregut do të jetë i pavarur nga të gjitha aktivitetet që nuk kanë të bëjnë me transmisionin e energjisë elektrike në formën e saj juridike, marrëdhëniet pronësore, strukturat organizative dhe vendim-marrëse.
3. Për të siguruar pavarësinë e Operatorit të Tregut, personat përgjegjës për menaxhimin e tij nuk mund të marrin pjesë në strukturat e kompanisë apo proceset vendimmarrëse të Ministrisë, Zyres së Rregullatorit për Energji, apo ndërmarrjeve tjera përgjegjëse për prodhimin, mirëmbajtjen, furnizimin, servisimin, shpërndarjen apo mihjen e thëngjillit apo furnizimeve tjera të lëndës djegëse.
4. Operatori i Tregut kryen të gjitha funksionet duke respektuar parimet e transparencës, objektivitetit dhe pavarësisë.

5. Operatori i Tregut përgatit propozimin për disajnin e tregut në përputhje me Strategjinë e Energjisë të Qeverisë. Dizajni i tregut aprovohet nga Zyra e Rregullatorit.

6. Mbi bazën e disajnit të tregut dhe mekanizimit balancues Operatori i Tregut përgatit rregullat e tregut me shumicë të cilat edhe i rishikon rregullisht në lidhje me ndryshimet që konsiderohen të arsyeshme dhe të nevojshme. Këto rregulla përfshirë edhe propozimet për ndryshim i dërgohen për miratim Zyrës së Rregullatorit për Energji. Pas miratimit, rregullat e tregut janë të detyrueshme për të gjithë pjesëmarrësit në tregun e energjisë elektrike.

7. Operatori i tregut është përgjegjës për menaxhimin ekonomik të sistemit elektroenergetik, menaxhon dhe operon tregun e energjisë elektrike, sipas kushteve të përcaktuara më këtë ligj dhe ligjet tjera të aplikueshme. Përgjegjësitë e tij përcaktohen në rregullat e tregut. Rregullat e tregut mund të përfshijnë njëjërën, disa apo të gjitha përgjegjësitë në vijim, si dhe përgjegjësi tjera:

7.1. evidentimin e të gjitha transaksioneve shitblerëse në tregun e energjisë elektrike;

7.2. organizimin e ankandëve për shitblerjen e energjisë, varësisht nga modeli i tregut dhe mekanizmave tregtues, bënë pranimin e ofertave(tenderëve) për furnizim me energji elektrike në kushtet e tregut të centralizuar;

7.3. njoftimin e pjesëmarrësve në Tregun e energjisë elektrike dhe Operatorin e Sistemit të Transmisionit mbi rezultatet e ankandëve dhe informata tjera rreth tregut;

7.4. pranimin e informatave nga Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes të cilat kanë ndikim në rezultatet e ankandit si pasojë e ndryshimit të kapaciteteve transmetuese dhe çfarëdo situatë tjetër të jashtëzakonshme në sistemin e transmisionit dhe shpërndarjes;

7.5. llogaritjen e sasive të energjisë elektrike që do të shfrytëzohen për çdo pjesëmarrës, për çdo periudhë të specifikuar në barazimet përfundimtare;

7.6. përcaktimin e çmimit në rastin e tregut të centralizuar për çdo periudhë kohore të specifikuar dhe njoftimin e të gjitha palëve pjesëmarrëse mbi detyrimet e ndërsjella.

7.7. themelimin e një sistemi kontabël (llogaritar) si dhe platformës për operimin e tregut.

7.8. administrimin e procesit të pagimit të faturave të përcaktuar në rregullat e tregut, për t'iu mundësuar pjesëmarrësve në treg pagimin e faturave për tregtimin e energjisë elektrike.

7.9. publikimin e informatave relevante të tregut.

Neni 25

Zhvillimi i Konkurrencës

Zyra e Rregullatorit për Energji në konsultim me Komisionin Kosovar të Konkurrencës dhe autoritetin përgjegjës për monitorimin e ndihmës shtetërore së paku çdo tri (3) vite do të kryejë hetime lidhur me funksionimin e tregut të energjisë elektrike si dhe të vendosë dhe imponojë të gjitha masat e nevojshme dhe proporcionale me qëllim të nxitjes të konkurrencës efektive dhe për të siguruar funksionimin e rregullt të tregut. Këta masa mund të përfshijnë programet për lëshimin e energjisë elektrike sipas të cilave ndërmarrjet e energjisë elektrike obligohen që të shesin ose të vendosin në dispozicion një sasi të caktuar të energjisë elektrike ose që t'i japin qasje furnizuesve të interesuar në një pjesë të kapacitetit të tyre prodhues për një periudhë të caktuar kohore.

KREU IX

E DREJTA E SHËRBIMIT UNIVERSAL, DHE KONTRAKTIMI I FURNIZIMIT

Neni 26

Konsumatorët me të drejtë për shërbimin universal

Në përputhje me paragrafin 1. të nenit 23 të këtij ligji, çdo konsumator shtëpiak ka të drejtën që të furnizohet me energji elektrike të një cilësie të specifikuar me çmime të arsyeshme, transparente dhe që mund të krahasohen në mënyrë të lehtë dhe të qartë.

Neni 27

Kërkesat kontraktuese

1. Të gjithë konsumatorët fundorë kontraktajnë shërbimin e furnizimit me energji elektrike me një furnizues, në bazë të kontratës e cila është në pajtim me rregullat dhe Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit të përcaktuara nga Zyra e Rregullatorit për Energji dhe me ligjet dhe rregullat tjera të aplikueshme . Furnizuesit sigurojnë se këto kontrata specifikojnë:

- 1.1. identitetin dhe adresën e furnizuesit;
- 1.2. shërbimet e ofruara, nivelin e cilësisë së shërbimit të ofruar, si dhe, aty ku zbatohet, kohën e kërkuar për kyçjen fillestare;
- 1.3. nëse ofrohen, llojet e shërbimeve të ofruara për mirëmbajtje;
- 1.4. masat përmes së cilave sigurohen informatat e përditësuara mbi të gjitha tarifatat dhe pagesat e mirëmbajtjes të aplikueshme;

1.5. kohëzgjatjen e kontratës, kushtet për ripërtëritje dhe ndërprerje të shërbimeve dhe të kontratës,

1.6. ekzistencën e të drejtave për tërheqje;

1.7. rregullimet e kompensimit dhe kthimit të parave të cilat zbatohen në rast se nuk përmbushen nivelet e cilësisë së shërbimit të kontraktuar, përfshirë faturimin e pasaktë dhe të vonuar; dhe

1.8. metodën e inicimit të procedurave për zgjidhjen e kontesteve.

2. Kushtet e kontratës janë të drejta dhe furnizuesit sigurojnë se kushtet paraprakisht njihen nga konsumatorët e tyre. Informatat mbi kushtet e kontratës duhet të ofrohen para përmbylljes apo konfirmimit të kontratës. Nëse kontratat përmbyllen përmes ndërmjetësve, informatat e specifikuara sigurohen edhe para përmbylljes së kontratës.

3. Furnizuesit sigurojnë se konsumatorëve u është dhënë njoftim adekuat i çfarëdo synimi për të modifikuar kushtet kontraktuese dhe se informohen mbi të drejtat e tyre për tërheqje pas ofrimit të njoftimit. Furnizuesit njoftojnë konsumatorët e tyre drejtpërsëdrejti mbi rritjet e tarifave, në kohë të duhur dhe jo më vonë se një periudhë normale e faturimit pas hyrjes në fuqi të rritjes, në mënyrë transparente dhe të kuptueshme. Furnizuesit sigurojnë se konsumatorët janë të lirë të tërhiqen nga kontratat nëse nuk pranojnë kushtet e reja të cilat u janë bërë të njohura.

4. Furnizuesit sigurojnë se kushtet dhe afatet e përgjithshme të kontratave të ofruara janë në pajtim me Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit. Afatet dhe kushtet ofrohen në gjuhë të qartë dhe të kuptueshme, nuk përfshijnë barriera jo kontraktuese për ushtrimin e të drejtave të konsumatorëve, për shembull dokumentacion të tepërt kontraktues, si dhe furnizuesit sigurojnë se konsumatorët mbrohen ndaj metodave të padrejta apo çorientuese të shitjes. Furnizuesit sigurojnë se konsumatorët e tyre:

4.1. kanë informata transparente mbi çmimet dhe tarifat e zbatueshme dhe mbi afatet dhe kushtet kryesore, përkitazi me qasjen dhe shfrytëzimin e shërbimeve të energjisë elektrike;

4.2. u është ofruar një zgjidhje e metodave të pagesës, si dhe se çdo dallim në afate dhe kushte pasqyron kostot e furnizuesit të sistemeve të ndryshme të pagesave.

4.3. nuk ngarkohen për ndërrim të furnizuesit;

4.4. përfitojnë nga procedurat transparente, të thjeshta dhe pakushtueshme për shqyrtimin e ankesave të tyre. Në veçanti, furnizuesit sigurojnë se konsumatorëve të tyre u ofrojnë të drejtën e shërbimit me standard të mirë dhe shqyrtim të ankesave, në mënyrë që të mundësohet zgjidhja e kontesteve në mënyrë të drejtë dhe të shpejtë, brenda tre (3) muajve, duke siguruar ofrimin e një sistemi për kompensim dhe/apo dëmshpërblim;

4.5. nëse kanë qasje në shërbim universal sipas dispozitave të këtij ligji, informohen mbi të drejtat e tyre përkitazi me atë shërbim universal;

4.6. informohen si duhet mbi konsumin aktual dhe kostot e energjisë elektrike aq shpesh sa të kenë mundësi të rregullojnë konsumin e tyre vetanak të energjisë elektrike. Ajo informatë ofrohet në një afat të mjaftueshëm kohor, duke marrë parasysh karakteristikat e pajisjeve matëse të konsumatorëve dhe produktin energjetik në fjalë. Do të mbahet shënim i duhur i regjistrit të efikasitetit të kostove të këtyre masave. Konsumatorët nuk do të ngarkohen me kosto shtesë për këtë shërbim; dhe

4.7. pranojnë llogarinë përfundimtare të mbylljes për çdo ndryshim të furnizuesit të energjisë elektrike, jo më vonë se gjashtë (6) javë pasi që të jetë ndryshuar furnizuesi.

Neni 28

Obligimi i kyçjes së konsumatorit dhe prodhuesit

1. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, sipas paragrafit 2. të këtij neni, duhet të lidhë në sistem çdo:

1.1. konsumator shtëpiak;

1.2. konsumator jo shtëpiak; dhe

1.3. prodhues.

2. Obligimeve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes të cekur në paragrafin 1. të këtij neni për ofrimin e kyçjeve i nënshtrohet edhe pala që kërkon kyçjen si:

2.1. posedimi i kutisë ndërprerëse elektrike të ndërtuar brenda kufijve të pronës së tij e cila i përmbush kërkesat teknike dhe operacionale të sigurisë;

2.2. plotësimi i kushteve për kyçje në sistemin e transmisionit apo shpërndarjes, përfshirë Kodin e Rrjetit dhe Kodin e Shpërndarjes, sipas kërkesës;

2.3. nënshkrimi i marrëveshjes me shkrim me Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes përkitazi me kyçjen, duke përfshirë pagesën e rregulluar për kyçje dhe pagesën për shfrytëzim të sistemit, sipas nevojës;

2.4. pagimi i të gjitha borxheve të papaguara të marrëveshjes për kyçje; dhe

2.5. nëse pala është konsumator, ofrimi i dëshmimeve të kënaqshme se ekziston kontrata e lidhur me furnizuesin për furnizimin e energjisë përmes kyçjes.

3. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes mund ta kyçë një konsumator i cili është me vendndodhje në territorin e një Operatori tjetër të Sistemit të Shpërndarjes, vetëm nëse ka siguruar leje me shkrim nga Zyra e Rregullatorit për Energji.

4. Kushtet dhe afatet për kyçje në sistemin e shpërndarjes apo të transmisionit, përcaktohen në Kodin e Rrjetit apo Kodin e Shpërndarjes.

Neni 29

Refuzimi i kyçjes në sistem

1. Konsumatorët ose prodhuesit e përmendur në nenin 27 të këtij ligji nuk kanë të drejtë të kyçen në sistem, nëse nuk i kanë plotësuar kriteret për kyçje, apo nëse kyçja do të shkaktonte çrregullime të mëdha në furnizim.

2. Operatori i Sistemit të Transmisionit apo Operatori i Sistemit të Shpërndarjes mund ta refuzojë përkohësisht kyçjen e një konsumatori ose prodhuesi në sistem, nëse konstaton se pajisjet e konsumatorit apo të prodhuesit dështon në plotësimin e normave teknike ose kushtet tjera të përshkruara në kodet teknike. Konsumatori ose prodhuesi duhet të informohet me shkrim për arsyet e çdo refuzimi të tillë. Konsumatori apo prodhuesi i cili është refuzuar ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi të tillë te Zyra e Rregullatorit për Energjisë, në pajtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë. Operatori i Sistemit të Transmisionit ose Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të kyçin një konsumator ose prodhues të licencuar pa vonesë (ose deri në datën e përcaktuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji) në sistemin e tyre në rastet kur Zyra e Rregullatorit për Energjisë vendos mbi një ankesë në të mirë të konsumatorit ose prodhuesit në fjalë.

Neni 30

Pezullimi dhe ndërprerja e përkohshme e furnizimit me energji elektrike

1. Furnizuesit dhe Operatorët e Sistemit të shpërndarjes kanë të drejtë të pezullojnë përkohësisht furnizimin me energji elektrike në bazë të rrethanave të përcaktuara në Ligjin e Rregullatorit për Energji dhe rregullin mbi Kushtet e Përgjithshme për Furnizim.

2. Furnizuesit kanë të drejtë të rregullojnë ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike për konsumatorët që nuk paguajnë detyrimet, në përputhje me kontratat për konsumatorët, rregullat e nxjerra nga Zyra e Rregullatorit për Energji, si dhe duke pasur parasysh vendimet e Zyrës së Rregullatorit për Energji që kanë të bëjnë me konsumatorët në nevojë dhe për t'ju shmangur ndërprerjeve gjatë sezonit të dimrit.

3. Furnizuesit do të ndërpresin furnizimin me energji elektrike ndaj konsumatorëve, në pajtim me rregullat e përcaktuara në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë. Këto rregulla do të përfshijnë të drejtën e furnizuesve për shkycjen e konsumatorëve fundor të cilët:

3.1. nuk kanë nënshkruar një kontratë me furnizuesin brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga pranimi nga konsumatori i një projekt kontrate për nënshkrim; ose

3.2. janë duke pranuar energji elektrike në mënyrë të pa autorizuar (ose janë në shkelje të dispozitave përkatëse të Kodit Penal ose këtij ligji).

KREU X MATJA DHE FATURIMI

Neni 31 Pajisjet matëse

1. Energjia elektrike e dërguar te konsumatorët apo e injektuar në sistem nga prodhuesit matet me pajisje matëse që duhet vendosur sa më afër që është e mundur në kufi të pronës së konsumatorit apo prodhuesit, në përputhje me kërkesat e Kodit të Matjes, i miratuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji.
2. Operatori i Sistemit të Transmisionit ose Operatori i Sistemit të Shpërndarjes përcakton tipin, numrin dhe vendin e montimit të pajisjes matëse si dhe kontrollin përkatës dhe mënyrat e komunikimit. Gjatë përcaktimit të vendit të montimit, Operatori i Sistemit të Transmisionit apo Operatori i Sistemit të Shpërndarjes siguron se qasja në njëhisor vihet në dispozicion për qëllime të mirëmbajtjes dhe leximit të pajisjeve matëse.
3. Operatori i Sistemit të Transmisionit ose Operatori i Sistemit të Shpërndarjes e instalon pajisjen matëse. Në rast se tarifat në fuqi ia mundësojnë një grupi të konsumatorëve të zgjedhin llojin dhe tipin e pajisjes matëse, Operatori i Sistemit të transmisionit ose Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do ta instalojë pajisjen matëse e cila korrespondon me zgjidhjen e konsumatorëve apo prodhuesve gjë që duhet të ceket me shkrim e që është në pajtim me Kodin relevant të matjes.
4. Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes sigurojnë ndërveprimin e këtyre sistemeve të pajisjeve matëse që do të zbatohen dhe i kushtojnë kujdes të duhur standardeve dhe praktikave më të mira dhe rëndësisë së zhvillimit të tregut të brendshëm të energjisë.
5. Operatori i Sistemit të Transmisionit apo Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, sipas nevojës, në përputhje me Kodin e Matjes ofrojnë qasje në të dhënat e matjes për konsumatorin apo furnizuesin e tij.

Neni 32 Përdorimi i pajisjeve matëse

1. Pajisjet matëse për matjen e energjisë elektrike janë pronë e Operatorit të Sistemit të Transmisionit ose Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, siç përcaktohet në Ligjin për Energjinë.

2. Me kërkesë të përdoruesit të sistemit dhe në llogari të tij mund të instalohet pajisja shtesë kontrolluese për matjen e prodhimit dhe konsumit të energjisë elektrike.
3. Në rast të çfarëdo dallimi në matjet e dhëna nga mjetet e referuara në paragrafët 1. dhe 2. të këtij neni, përtej nivelit të pranueshëm të pasaktësisë teknike, çështja do të zgjidhet në pajtim me procedurat e specifikuara në Kodin e Matjes.

Neni 33

Faturimi dhe pagesa

1. Konsumatorët duhet të paguajnë energjinë elektrike të konsumuar në pajtim me Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me energji elektrike apo kushtet tjera kontraktuese të aplikueshme.
2. Kushtet dhe procedurat për faturim, inkasim të faturave, dhe pagesa përcaktohen në Rregullin mbi Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji Elektrike të nxjerrë nga Zyra e Rregullatorit për Energji.

KREU XI

RRJEDHAT NDËRKUFITARE TË ENERJISË ELEKTRIKE

Neni 34

Importi dhe eksporti

Përveç në rastet e përcaktuara në pjesët tjera të këtij ligji, importi dhe eksporti i energjisë elektrike mund të kryhet apo rregullohet nga ndërmarrjet që kanë licencë të lëshuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji që lejon aktivitete të tilla. Nuk do të ketë asnjë kufizim në numrin e të licencuarve.

Neni 35

Transiti

1. Nëse kërkohet, Operatori i Sistemit të Transmisionit kryen transit të energjisë elektrike në sistemin e transmisionit në pajtim me dispozitat e Kodit të Rrjetit.
2. Në përputhje me rregullat e tregut, Operatori i Tregut menaxhon dhe Operatori i Sistemit të Transmisionit aranzhon qasje në kapacitetet e interkoneksionit.
3. Operatori i Sistemit të Transmisionit siguron se për pjesëmarrësit e tregut ofrohet në dispozicion kapaciteti maksimal i interkonektorëve dhe rrjeteve të transmisionit që prekin rrjedhat ndërkufitare, me kusht që ato të jenë në pajtim me standardet e sigurisë për operim të sigurt të sistemit. Pjesëmarrësit e tregut informojnë Operatorin e Tregut, në një kohë të arsyeshme para periudhës relevante të operimit, nëse synojnë shfrytëzimin e

kapacitetit të ndarë, si dhe nëse kapacitetet e ndara që nuk do të shfrytëzohen do të ringarkohen (rikthehen) në treg, në mënyrë të hapur-transparente dhe jodiskriminuese. Operatori i Sistemit të Transmisionit, nëse është teknikisht e mundur, kapin kërkesat për kapacitet të të gjitha rrjedhave të energjisë në drejtime të kundërta në të gjithë interkonektorët e kongjestuar, në mënyrë që të shfrytëzojnë interkonektorët në kapacitetin e tyre maksimal. Operatori i Sistemit të Transmisionit, duke i kushtuar vëmendje të duhur sigurisë së sistemit, siguron se transaksionet që lirojnë kongestionin nuk refuzohen kurrë.

4. Kongjestioni (mbingarkesa) do të adresohet me zgjidhje jodiskriminuese të bazuara në treg, të cilat ofrojnë sinjale efikase ekonomike për pjesëmarrësit e tregut dhe Operatorin e Sistemit të Transmisionit dhe të tjerët të përfshirë. Problemet e kongestionit preferohet të zgjidhen me metodat të pabazuara në transaksione, do të thotë metoda që nuk përfshijnë përzgjedhje ndërmjet kontratave të pjesëmarrësve individualë të tregut. Procedurat e shkurtimit të transaksioneve shfrytëzohen vetëm në situata emergjente, kur Operatori i Sistemit të Transmisionit duhet të veprojë në mënyrë të shpejt dhe kur nuk është i mundur dispeçimi i serishëm apo tregtimi me letra me vlerë. Të gjitha procedurat e tilla zbatohen në mënyrë jodiskriminuese. Përveç në raste të forcës madhore, pjesëmarrësit e tregut që kanë kapacitet të ndarë, do të kompensohen për çdo kufizim.

Neni 36

Pagesat për shfrytëzim të interkonektorëve

1. Pagesat për qasje në interkonektorë duhet të përcaktohen mes Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe operatorëve të sistemeve tjera nacionale, të cilave u referohet në nenin 35 të këtij ligji, procedurat e miratuara dhe marrëveshjet apo obligimet tjera ndërkombëtare. Këto pagesa nuk do të ndërliqhen me distancën.

2. Pagesat për qasje në sistemet e transmisionit përfshirë interkonektorët, do të sigurojnë sinjale të përshtatshme dhe efikase lidhur me lokacionin. Pagesat për qasje në sistem të transmisionit apo interkonektorë e cila zbatohet për prodhues dhe konsumatorë duhet të jetë e zbatueshme pa marrë parasysh shtetin e destinimit respektivisht të origjinës së energjisë elektrike, gjë që duhet të specifikohet në marrëveshjen komerciale gjegjëse. Kjo duhet bërë pa paragjykim ndaj pagesave që rezultojnë nga mekanizmat për menaxhim të kongestionit që zbatohen në pajtim me këtë ligj.

3. Të gjitha të ardhurat e pranuar nga Operatori i Sistemit të Transmisionit që rrjedhin nga shfrytëzimi i interkonektorëve duhet të shfrytëzohen për të garantuar disponueshmërinë aktuale të kapaciteteve të alokuara dhe investime në rrjet për të mirëmbajtur apo ngritur kapacitetet e interkonektorëve.

4 Nëse të ardhurat e pranuar nga Operatori i Sistemit të Transmisionit nuk mund të shfrytëzohen në tërësi në mënyrë efikase për qëllimet e parapara me paragrafin 3. të këtij neni, Zyra e Rregullatorit për Energji do të specifikojë vlerën maksimale të këtyre të ardhurave që duhet marrë parasysh gjatë miratimit të metodologjisë për kalkulimin e tarifave të sistemit dhe gjatë vlerësimit të nevojave për modifikim të tarifave. Të gjitha të

ardhurat e mbetura do të vendosen në një linjë të ndarë të llogarisë deri në kohën kur mund të shpenzohen për qëllimet e parapara në paragrafin 3. të këtij neni.

Neni 37

Informatat përkitazi me rrjedhat ndërkufitare

1. Operatori i Sistemit të Transmisionit është përgjegjës për zhvillimin e një skeme të përgjithshme për llogaritjen e kapacitetit total për transfer dhe marginën e besueshmërisë së transmisionit, bazuar në tiparet elektrike dhe fizike të rrjetit. Operatori i Sistemit të Transmisionit parashtron këtë skemë dhe ndryshimet e mundshme pasuese të saj për aprovim në Zyrën e Rregullatorit për Energji, si dhe e publikon atë pas aprovimit.
2. Operatori i Sistemit të Transmisionit gjithashtu publikon vlerësimet e përafërta të kapacitetit të disponueshëm për transfer për çdo ditë, duke shënuar kapacitetin e disponueshëm të transferimit tanimë të rezervuar. Këto vlerësime publikohen në intervale të specifikuara para ditës së transmetimit dhe përfshijnë, gjithmonë, vlerësimet paraprake njëjavore dhe mujore, si dhe shënimin indikativ të besueshmërisë së pritur të kapacitetit në dispozicion.
3. Zyra e Rregullatorit të Energjisë i siguron Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë apo institucionit tjetër kompetent të gjitha informatat mbi rrjedhat ndërkufitare të energjisë elektrike që mund të kërkohen sipas kushteve të marrëveshjeve në fuqi, apo obligimeve në kontekst të Komunitetit të Energjisë.

KREU XII

DISPOZITAT KALIMTARE, NDËSHKIMORE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 38

Importi gjatë periudhave të pamjaftueshmërisë së prodhimit

1. Një ndërmarrje e energjisë elektrike në pronësi publike, që nuk mund të jetë Operatori i Sistemit të Transmisionit, do të ketë obligimin për importimin e energjisë elektrike të nevojshme për plotësimi e nevojave të konsumatorëve të pakualifikuar në periudhat kohore kur (i) prodhimi vendor është i pamjaftueshëm, dhe (ii) në mungesë të këtyre importeve, konsumatorët do t'i nënshtrohen shkyçjes;
2. Çdo kompensim i cili i bëhet kësaj ndërmarrje të energjisë elektrike në pronësi publike për importimin e energjisë elektrike e cila nuk është pasqyruar në tarifa do të bëhet në pajtim me paragrafin 4. të nenit 16 të Ligjit për Energji dhe do të njoftohet në institucionet përkatëse sipas legjislacionit të aplikueshëm për ndihmën shtetërore.
3. Obligimi i krijuar në paragrafin 1. të këtij neni do të shfuqizohet më së voni me 1 Janar 2015, ose më herët në rast se kapaciteti prodhues i instaluar dhe në dispozicion në sistemin e energjisë elektrike në Kosovë vlerësohet nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë

se është i mjaftueshëm për plotësimin e nevojave të konsumatorëve të pakualifikuar të energjisë elektrike.

4. Asnjë dispozitë e këtij neni nuk e kufizon të drejtën e ndërmarrjeve të tjera të energjisë elektrike për eksportimin dhe importimin e energjisë elektrike.

Neni 39

Vjedhja e Energjisë Elektrike dhe Veprat tjera Penale që ndërlidhen me Energjinë Elektrike

1. Në këtë nen janë përcaktuar veprat penale që ndërlidhen në mënyrë specifike me vjedhjen e energjisë elektrike, manipulimin e pajisjeve matëse të energjisë elektrike, anashkalimin e pajisjeve matëse të energjisë elektrike dhe kyçjen ose ri-kyçjen në mënyrë të paautorizuar në një furnizim të energjisë elektrike që transmetohet nga ose përmes një sistemit të transmisionit ose shpërndarjes së energjisë elektrike. Për këto vepra penale zbatohen dispozitat në vijim:

1.1. çdo person që merr, shfrytëzon, nxjerr ose përfiton nga energjia elektrike e cila furnizohet nga ose përmes një rrjet i transmisionit ose shpërndarjes pa lejen ose autorizimin e furnizuesit përkatës do të dënohet me një gjobë dhe/ose burgim siç është përcaktuar në paragrafin 7. të këtij neni;

1.2. çdo person i cili lidhet ose ri-lidhet në një rrjet të transmisionit ose shpërndarjes së energjisë elektrike përmes çfarëdo mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë dhe për çfarëdo qëllimi pa lejen ose autorizimin e furnizuesit përkatës do të dënohet me një gjobë dhe/ose burgim siç është përcaktuar në paragrafin 7. të këtij neni;

1.3. çdo person i cili lejon që një lidhje ose ri-lidhje e paautorizuar në një rrjet të transmisionit ose shpërndarjes të jetë e vendosur ose të furnizojë pronën në posedim, pronësi ose kontroll të tij/saj dhe që nuk e njofton menjëherë furnizuesin përkatës për ekzistimin e kësaj lidhje ose ri-lidhje të paautorizuar do të dënohet me një gjobë dhe/ose burgim siç është përcaktuar në paragrafin 7. të këtij neni;

1.4. çdo person që ndryshon regjistrimin e një pajisje matëse që përdoret për matjen e sasisë së energjisë elektrike e cila i furnizohet një objekti nga një furnizues i energjisë elektrike ose që ndërhyr në një pajisje matëse ose matje, do të dënohet me një gjobë dhe/ose burgim siç është përcaktuar në paragrafin 7 të këtij neni. Për qëllime të këtij paragrafi, ndërhyrja në një pajisje matëse ose në matjen e energjisë elektrike përfshin, por nuk kufizohet vetëm në veprat në vijim:

1.4.1. manipulimi i një pajisje matëse;

1.4.2. largimi i paautorizuar ose dëmtimi i një vule apo blombe zyrtare të vendosur në pajisjen matëse nga një person i autorizuar me qëllim të sigurimit të njehsorit;

1.4.3. instalimi apo përdorimi i një pajisje matëse të manipuluar;

1.4.4. instalimi apo përdorimi i një transformatori të manipuluar të rrymës;

1.4.5. manipulimi, ndryshimi ose anashkalimi i një transformatori të rrymës ose transformatori të volazhit (tensionit);

1.4.6. dëmtimi ose ndryshimi i paautorizuar i dizajnit, funksionimit, performancës, ndërtimit të çfarëdo pajisje matëse ose matje; dhe/ose

1.4.7. instalimi ose përdorimi i çfarëdo pajisje ose metode tjetër që ndërhyt me regjistrimin, kalibrimin ose matjen e saktë dhe/ose të rregullt të energjisë elektrike.

1.5. Kur një person ndiqet penalisht për kryerjen e një vepre penale të përcaktuar në nën-paragrafin 1.4 të këtij paragrafi, posedimi nga ky person i mjeteve artificiale për ndryshimin e regjistrimit të një pajisje matëse ose, sipas rastit, parandalimin e një pajisje matëse nga regjistrimi i rregullt nëse pajisja matëse ka qenë në kujdestari ose kontroll të tij, do të konsiderohet dëshmi *prima facie* se ndryshimi ose parandalimi është shkaktuar qëllimisht nga ai;

1.6. çdo person i cili lejon që një pajisje matëse e manipuluar ose anashkaluar të ekzistojë ose të furnizojë me energji elektrike të pa-matur ose të matur në mënyrë të parregullt në pronën që është në posedim, pronësi ose kontroll të tij dhe që nuk e njofton menjëherë furnizuesin përkatës për ekzistimin e kësaj pajisje matëse të manipuluar ose të anashkaluar do të dënohet me një gjobë dhe/ose burgim siç është përcaktuar në paragrafin 7. të këtij neni;

1.7. çdo person që pengon, sulmon ose merr pjesë në një grup që pengon ose sulmon një person i cili kryen detyrën e tij dhe është i punësuar ose i angazhuar nga një subjekt i licencuar për prodhimin, transmisionin, shpërndarjen ose furnizimin e energjisë elektrike do të dënohet në përputhje me nenet 316-318 të Kodit të Penal i cili është në fuqi në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji ose në përputhje me dispozitat përkatëse të kodit pasardhës të tij;

1.8. çdo person që ofron çfarëdo ndihme ose që inkurajon një person tjetër në kryerjen e veprave penale të përcaktuara në këtë nen do të dënohet me një gjobë dhe/ose burgim siç është përcaktuar në paragrafin 7. të këtij neni.

2. Kur një vepër penale e përcaktuar në këtë nen është kryer nga një organizatë që është person juridik ose çfarëdo lloj organizate tjetër që ka zyrtarë dhe/ose drejtorë, organizata dhe secili drejtor dhe zyrtar i kësaj organizate do të konsiderohet fajtor për kryerjen e asaj vepre penale, përveç siç është përcaktuar në paragrafin 4. të këtij neni.

3. Kur një vepër penale e përcaktuar në këtë nen është kryer nga një organizatë që është ortakëri, organizata dhe çdo person fizik i cili është ortak ose i cili është zyrtar ose drejtor

i një ortaku do të konsiderohet fajtor për kryerjen e asaj vepre penale përveç siç është përcaktuar në paragrafin 4. të këtij neni.

4. Pavarësisht nga paragrafët 2. dhe 3. të këtij neni, një person fizik nuk do t'i nënshtrohet asnjë dënimi nëse ai person dëshmon se vepra penale është kryer pa dijeninë e tij ose se ai/ajo ka bërë përpjekje maksimale për të parandaluar kryerjen e veprës penale.

5. Ndjekja penale e një vepre penale të përcaktuar në këtë nen do të iniciohet pas dorëzimit të një propozimi nga furnizuesi përkatës në prokurorinë publike në pajtim me dispozitat e aplikueshme të Kreut V të kodit të procedurës penale i cili është në fuqi në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji ose në përputhje me dispozitat përkatëse të kodit pasardhës të tij.

6. Për qëllime të këtij neni, termi “furnizues përkatës” nënkupton një person ose ndërmarrje të autorizuar me një licencë ose përjashtim për furnizimin e energjisë elektrike. Termi “person” nënkupton dhe përfshin një person fizik, person juridik dhe çdo organizatë tjetër.

7. Gjambat dhe dënimet e përcaktuara në këtë nen do të shqiptohen dhe vendosen si vijon:

7.1. për zyrtarët, drejtorët dhe ortakët e një personi juridik ose një organizate tjetër dhe për personat e tjerë fizik; shkelja për herë të parë pesëqind (500) Euro; shkelja për herë të dytë dymijë (2.000) Euro; shkeljet për çdo herë tjetër pas shkeljes së dytë pesëmijë (5.000) Euro, dhe me burg sipas dispozitave të Kodit Penal të Kosovës;

7.2. për personat juridik ose organizatat tjera shkelja për herë të parë pesëmijë (5.000) Euro; shkelja për herë të dytë njëzetmijë (20.000) Euro; shkeljet për çdo herë tjetër pas shkeljes së dytë pesëdhjetëmijë (50.000) Euro.

Neni 40 **Dispozitat kalimtare**

1. Ky Ligj shfuqizon Ligjin për Energjinë Elektrike Nr. 2004/10, ndërsa të gjitha aktet, vendimet, rregullat dhe dokumentet tjera të miratuara apo të shpallura sipas Ligjit Nr. 2004/10 do të harmonizohen me këtë ligj brenda nëntë (9) muajve pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

2. Zbatimi i nën-paragrafëve 1.3., 1.4. dhe 1.11. paragrafi 1. të nenit 12 të këtij ligji varet nga një vendim implementues i cili duhet të nxirret nga Ministri pas konsultimit me Zyrën e Rregullatorit për Energji dhe Operatorin e Sistemit të Transmisionit.

Neni 41
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 03/L-201
7 tetor 2010

Anëtari i Kryesisë së Kuvendit

Xhavit HALITI